

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXII i botimit, nr. 247, Maj 2024
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Gjergj Kastrioti, figura përbashkuuese e kombit shqiptar!

2



21-vjetori i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"

Me datën 11 maj 2024, në sallën "Mikel Koliqi", me muzikë me motive dukagjinase në sfond filloi veprimtaria festive kush-tuar nxënësve të dalluar të klasës së IX dhe maturanteve dukagjinase, në kuadrin e 21 vjetorit të themelimit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", e cila u themelua me vendim të gjykatës së shkallës së Parë në Tiranë, nr. 666, datë 13 maj 2003 dhe eci me moton "Mos pyet çfarë beri Dukagjini për mua, por çfarë bëra unë për Dukagjini", nën drejtimin e Kryetares së Këshillit të Shoqatës, zonjës Dukat Bregu.

Nderuan këtë veprimtari:

N/Kryetarja e Bashkisë Shkodër, zonja Teuta Qyteza;

Përfaqësues të Shoqatës "Martin Dreshaj", me qendër në Pejë, me kryetarin e saj, z. Ukshin Jashari

Kryetari i Lëvizjes për Shqipërinë e Bashkuar, z. Frashër Racaj

Kryetarja e shoqatës kulturore "Xhubbleta e Alpeve Shqiptare", zonja Rita

ERNEST KOLIQI - MENDJA E NDRITUR QË E PËRBUZI VENDLINDJA

9

Ernest Koliqi ishte poet, romancier, eseist, përkthyes, gazetar, dramaturg, albanolog, mësues dhe botues shqiptar. Cilësohet themelues i tregimit modern shqiptar.



SHOQËRIA, TURBULENCAT DHE PATOLOGJITË QË CËNOJNË EKUILIBRIN E BRENDSHËM TË SAJ

Me sociologun Gëzim TUSHI,
"Mjeshtër i MADH", "Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut"

- Shqipëria po përjeton një situatë të dhimbshme kriminale, ku del në pah një dhunë e pashpjegueshme ndaj femrës. Si mund ta konsideroni ju këtë situatë dhe cilat do të ishin rrugët për ta kapërcyer këtë gjendje?

-Realitetet sociale në shoqërinë shqiptare kanë kohë që janë të inonduara nga shumë dukuri shqetësuese, të cilat tregojnë dobësimin deri në nivele kritike të shëndetit, kohezionit dhe funksionalitetit të saj. Për nga gjerësia e shtrirjes dhe intensiteti i shfaqjes së disa dukurive, si dhuna, krimi, neurotizmi social, konfliktet në familje, fenomeni i bullizmit në shkollë, divorci në gjerim ...

10

Gjenerali Tahir Sinani ngeli në zemrat dhe mendjen e Shqiptareve, heroi i Shqipërisë, Kosovës, Preshevës dhe Maqedonisë së Veriut

Tahir Sinani lindi me 25 Maj 1964 në fshatin piktoreske Gri e Njësisë Administrative Bujan, Bashkisë së Tropojës dhe ra dëshmorë me 29 Korrik 2001 në vendin e quajtur "Zabel i Kukullit" afër qytetit të Gostivarit të Maqedonisë së Veriut.

Tahir arsimin e detyrueshëm e kreu në vendlindje dhe të mesëm për agronomi, në qytetin Bajram Curri. Pas mbarimit të shkollës së mesme përfundojë në Zall-Herr të Tiranës, në shkollën ushtarake në degën e armës së kimisë e Biologjike me rezultate të larta, duke u bere mjeshtër i përsosur i përdorimit të të gjitha llojeve të armëve. Kështu, në moshën 27 vjeç emërohet instruktor ...

13

Gjergj Kastrioti, figura përbashkuuese e kombit shqiptar!



Poeti **Raif Gashi**, drejtuesi i Konferencës Shkencor

Më 6 maj 2024, në Institutin Albanologjik në Prishtinë, nën drejtimin e shoqatës “Kufijtë e Arbrit”, “Lëvizjes Shqiptaria” dhe “Lëvizja e Deçanit?”, u kremtua ditëlindja e kryeheroit kombëtar, Gjergj Kastrioti-Skënderbeut, për të cilën u mbajt simpozium shkencor për veprën dhe historinë e lavdishme që la vullë të pashlyeshme ndër breza.

Mbi këtë figurë unifikuese të gjitha kohërave pati mbi 30 kumtesa, ku shumica nga to nuk u lexuan për shkak të kohës së kufizuar, por sipas Moderatorit kumtesat do të botohen në revistën Arbëria.

Në këtë simpozium me ligjërata të veçanet u paraqit edhe Shoqata Atdhetare “Dukagjini” nga Shkodra, në të cilën kryetari Ndue Sanaj dhe znj. Dukate Bregu, mbas përsëritjes filloi fjalimin me fjalët: “Ky organizim, në analizën tonë, është tepër i veçantë, veçanërisht nga tema e saj “Prezantimi i jetës dhe veprës së heroit tonë gjithëkombëtar Gjergj Kastrioti”, është mjaft e gjetur në kohë, që do të thotë, ka ardhur koha të themi “Kushtrimi i Gjergj Kastriotit!”, se duhet një personalitet kombëtar, rreth të cilit të bashkohet gjithë kombi shqiptar”.

Nga trajtesat e lexuara u trajtuan shumë gjëra historike dhe qëllimi i luftës së Gjergj Kastriotit, duke i parafrazuar shkruarit e historisë së kohës, mbi të gjitha duke u mbështetur në librin e Barletit. Por, në kumtesat e tyre u fol edhe për përpjekjet e disa shkruarëve shqipfolës, të cilët edhe sot përpiqen ta deformatojnë luftën unifikuese të Gjergj Kastriotit, duke e paraqitur si mbrojtës së krishterimit dhe kundërshtar të islamit.

Me kumtesat e tyre u paraqiten historian dhe studiues të veçantë: Dr. Nysret Pllana, “Zëri i Art i Radios Kosava e Lirë”, Dr. Lulzim Lajçi, Njazi Gashi e të tjerë.

Ndër të tjera u theksua se atdheut po i vjen rreziku nga ata që kulturat fetare të huaja po i sjellin në troje shqiptare.

Rruga e ndritshme e Gjergj Kastriotit, i

cili me shkathtësinë e tij intelektuale, politike e atë strategjike ushtarake arriti unifikimin e të gjitha principatave shqiptare të asaj kohe, prandaj në duhet ta ndjekim atë rrugë të suksesit.

Në përmbyllje të simpoziumit shkencorë të pranishmit ju bashkuan mijëra qytetarëve, të cilët kishin dal në sheshin “Gjergj Kastrioti - Skënderbeut” në Prishtinë, për ta festuar ditëlindjen e kryeheroit kombëtar Gjergj Kastrioti i lindur më 6 maj 1405.

Në këtë Manifestim të ditëlindjes së kryeheroit, pjesëmarrës ishin nga të gjitha trevat shqiptare dhe nga bashkësia arbëreshe, të përcjellë me këngët e valle të artistëve të mëdhenj të kombit: Kastriot Tusha, Shkurte Fejza, Nikoll Nikprelaj, Selami Kolonja, Enkelejda Arifi, Hysni Alushi, Irma Libohova e të tjerë,

Në këtë koncert madhështor Shoqata Atdhetare “Dukagjini” u paraqit me këngëtarët: Gentian Grova, Noel Pjetri, Viola Shqau, Gjon Kosteri, Kole Hasanaj, Gege Zefi e të tjerë.

I madhërishtëm ishte edhe aktori i përmasave gjithëkombëtare i ardhur enkas nga SHBA, Xhevat Limani, i cili i impresionoi të pranishmit me rolin e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, duke deklamuar fjalë nga fjalët e Gjergj Kastriotit, që u mirëprit nga të pranishmit, të cilët ishin të shumte në numër të ardhur nga të gjitha trojet e Arbrit.

Gjatë marshimit të qytetarëve, duke filluar nga Katedralja e deri te sheshi i “Gjergj Kastrioti” jehonte kënga nga grupe këngëtaresh e valltaresh, të cilët kishin dalë ta festonin ditëlindjen e kryeheroit. Këtë paraqitje e bënte edhe ma madhështor veshja me përkrenaren mbi kokë dhe pallton të veshur si Gjergji në kohën e tij. Po ashtu mbanin në dorë fotografit e Gjergj Kastriotit dhe dëgjoheshin biseda ndër pjesëmarrësit se duhet të dal një bir i kombi si Gjergj Kastrioti që të na bashkoj përsëri, se sot jemi të rrezikuar nga prurje të shumtat të lloj-lloj fesh, vetëm e vetëm për ta dobësuar trungun e lashtë dhe të pastër të Arbrit.

Manifestimi mbaroi me këngë e valle dhe me uratën: Urime ditëlindja o kryeheroi ynë Gjergj Kastrioti!

Nga Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, mori pjese grupi përfaqësues i përbërë: Ndue Sanaj, Kole Çardaku, Prele Milani, Dukate Bregu, Viola Shqau, Prele Shytani, Martin Arra, Gege Zefi, Gentijan Grova e Noen Pjetri.

Trajtesa e plotë e ligjëruar nga Kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Ndue Sana dhe znj. Dukate Bregu, me titull

“Kushtrimi i Gjergj Kastriotit!”

Të nderuar organizator të kësaj veprimtarie kushtuar shqiptarisë!

Të nderuar pjesëmarrës!

Zonja e zotërinj!

Ky organizim, në analizën tonë, tepër i veçantë, veçanërisht nga tema e saj “Prezantimi i jetës dhe veprës së heroit tonë gjithëkombëtar Gjergj Kastrioti”, është mjaft e gjetur në kohë, që do të thotë, ka ardhur koha të themi “Kushtrimi i Gjergj Kastriotit!”, se duhet një personalitet kombëtar, rreth të cilit të bashkohet gjithë kombi shqiptar.

Në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe grupit përfaqësues të saj, ju them: Mirë se u gjetëm dhe na u priftë e mbara në realizimin e misionit tonë!

Kurrë kombi shqiptar nuk ka qenë më në pozita bashkimi, se sa sot, se para 30 viteve as që mund të imagjinoheshin!

Sot janë dy republika shqiptare: Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë apo e shtetit Amë; në Republikën e Maqedonisë së Veriut, shqiptarët janë shtet formues dhe nesër në qoftë se shqiptarët e besimit ortodoks deklarohen shqiptar, shqiptarët dalin formues i shtetit të Maqedonisë; para 10 viteve në Malin e Zi as që mendohej se do të kishim sot shkollën shqipe, se do të kishim simbolet kombëtare; çështja e Çamërisë është më shumë e sensibilizuar sa asnjë here tjetër ... Në këtë situatë, me 16 korrik 2016, është themeluar Shoqata “Lëvizja për Shqipërinë e Bashkuar”, që objekti i pare i së cilës është prioritet bashkimi i Republikës së Kosovës me republikën e Shqipërisë, që dhe kjo është me dy anë të saj pozitive e negative. Më mirë, një votë në strukturat ndërkombëtare apo dy vota, që për ne është më mirë një votë e fuqishme, se me këtë votë shqiptarët në vartësi të shteteve të tjera Ballkanike do të jenë më të sigurtë, më të mbrojtur.

Sot, 619 vite më pare lindi Gjergj Kastrioti, ai Gjergj, që në moshën 38 vjeçare mori Krutjen, kryeqytetin e Arbërisë, me 28 nëntor 1443 dhe disa muaj më pas, me 2 mars 1444, me vendim të Kuvendit të Lezhës u vu në krye të Arbërisë, në krye të ushtrisë së Arbërorëve dhe për 25 vite radhas fitoi 32 betejë me osmanllëq, me përjashtim të betejës së Sfetigradit, dhe renditet një nga personalitetet më me emër në Botë, një nga strategët e veçantë, ndër 12 dhjetë strategët ushtarake në Botë, është renditur i dhjetë, që solli në

Artin ushtarak një risi të re, që nuk është sasia që siguron fitoren, por është cilësia e pajisur me një shpirt të lartë e të thellë luftarak për të mbrojtur të drejtat legjitime.

Për këtë strateg me emër në botë, theksohej:

Lider botërore, që vijne vetëm një herë në jetë, dhe që lenë shenjë në historinë e civilizimit njerëzor dhe i tillë ishte dhe Gjergj Kastrioti:

Të mos përfshijë komandantin ushtarak të njohur si Gjergj Kastrioti në listë nuk do të ishte e drejtë. Arsyeja që ai bëhet pjesë e kësaj listë është fakti që pavarësisht sa armiq kishte, ai arriti të mbizotëronte dhe u bë pengesë e Perandorisë Osmane për të pushtuar Evropën. I lindur me emrin Gjergj Kastrioti në principatën e vogël të Kastriotëve, Albanoi.

Ai u zu rob nga sulltani osman. Duke u rritur në radhët e ushtrisë osmane ai u rrit edhe për t'u bërë një prej gjeneralëve më të mëdhenj duke fituar titullin “Skënderbe”, që do të thotë Zoti Aleksandër, që e barazonte atë me heroizmat e Aleksandërit të Madh. Por kjo nuk e pengoi të kthehej në vendin e tij, gjë që zemëroi Perandorinë Osmane, që për 25 vjet me radhë dërgoi ushtri të stërmëdha për ta pushtuar Arbërinë apo Albaninë, por pa sukses. Me ushtritë e tij që nuk arrinin në më shumë se 20 mijë njerëz, Gjergj Kastrioti arrinte t'i bënte ballë ushtrive dhjetë herë më shumë trupave të armikut. Për mbrojtjen e Evropës Perëndimore nga hordhitë osmane, Papa i dha titullin “Kampion i Krishtit” Gjergj Kastriotit.

Gjergj Kastrioti, lindi me 6 maj 1405–17 janar 1468, i njohur si Skënderbeu (nga osmanishtja: رادنكسا گب İskender Bey), ishte një fisnik dhe udhëheqës ushtarak shqiptar. Gjergj Kastrioti gjithmonë e nënshkroi veten si Zot i Arbërisë (latinisht: Dominus Albaniae), dhe nuk pretendoi tituj të tjerë përveç tij në dokumentet zyrtare.

Një anëtar i familjes fisnike të Kastriotëve, ai u dërgua si peng në oborrin perandorak osman, ku u arsimua dhe hyri në shërbim të sulltanit për njëzet vitet e ardhshme. Ai u ngrit sipas gradave, duke kulminuar në emërimin si sanxhakbej i Sanxhakut të Dibrës në vitin 1440. Në vitin 1443, ai braktisi osmanët gjatë betejës së Nishit dhe u bë sundimtar i Krutjës, Sfetigradit dhe Modriçit. Në vitin 1444, ai u emërua prijës i Lidhjes së Lezhës, që konsolidoi fisnikërinë në atë

që sot është Shqipëri. Përkundër vlerës së tij ushtarake, ai nuk ishte në gjendje të bënte më shumë se sa të mbante zotërimet e tij brenda një treve shumë të vogël në Shqipërinë e veriut, ku ndodhën pothuajse të gjitha fitoret e tij kundër osmanëve. Gjergj Kastrioti zhvil-





loi luftë mbrojtëse, dhe për 25 vjet, nga viti 1443 deri në vitin 1468, ushtria 10000 anëtarësh e tij luftoi e fitoi kundër forcave osmane, të cilat ishin vazhdimisht më të mëdha dhe më të furnizuara, gjë për të cilën u admirua.

Në vitin 1451, nënshkroi një traktat me Alfonsin e Napolit për të siguruar një aleancë mbrojtëse, edhe pse ai mbeti një sundimtar de facto i pavarur. Në vitet 1460–1461, ai mori pjesë në luftërat civile të Italisë në mbështetje të Ferdinandit i të Napolit. Në vitin 1463, ai u bë komandanti kryesor i forcave kryqtarë të papa Piut II, por papa vdiq ndërsa ushtritë ende po mblidheshin. Së bashku me venedikasit ai luftoi kundër osmanëve gjatë Luftës osmano-venedikase të viteve 1463–79, deri në vdekjen e tij në janar të vitit 1468.

Aftësitë ushtarake të Gjergjit përbënin një pengesë të madhe për zgjerimin osman, dhe ai u konsiderua nga shumë njerëz në Evropën Perëndimore si një model i rezistencës së krishterë ndaj muslimanë. Sot, ndër shqiptarë, Gjergj Kastrioti njihet si heroi nacional i tyre, trashëgim e të cilit është e dukshme në të gjithë trevat shqiptare.

Në situatën e krijuar për kombin shqiptar, mendojmë se ka ardhur koha të lexojmë thirrjen e Ernest Koliqit, bërë në muajin Maj 1924, me titull “Kushtrimi i Gjergj Kastrioti”

Ç’asht moj Zanë kjo gjamë nga malet,
Ç’asht kjo ushtimë që kurr nuk ndalet,
Lshon kushtrimin Gjergj Kastrioti,
Dridhet toka, tundet dheu.

N’kambë shqiptarë ju me u çue,
Me ngjesh armët me luftue,
Ka ardhë dita e Lirisë,
Dërmen me ia dhanë osmanllisë.

N’ kështjellë të Krujës valon krenar,
Njaj flamuri fitimtar,
Njaj flamuri kuq e zi,
Që n’ shekujt veç ka pri.

N’ Lezhë shpejt mblidhet një kuvend:
Flasin princat rend me rend,
Gjergji një fjalë ka thanë:
Të bashkuem t’ jemi te tanë.

Lezhë qytet i Ilirisë,
Mblodhe burrat e Shqipnisë,
N’ krye qëndron GJERGJ KASTRIOTI,
I Shqiptarve Princ Kryezoti.

Pa ndigjo Sulltan Murati,
Për njat kryq që mbaj në gji,
Me marrë Krujën je ba gati,
Gjithë ushtrinë kam me ta gri!

Fort tërbua asht Sulltani,
E ka dyndun gjithë ushtrinë,
Rrethim Krujës veç i bani,
Ban llogarinë pa analizë,

Se jo, Kruja nuk dorzohet,
Gjergji fort e mbron,
Njaj Murati krejt tërbohet,
Prej trishtimit ma nuk rrnon.

Gjith Evropa n’ kamb asht çua,
Mbretën, Roma e Venediku,
Gjergj Kastrioti kjoftë nderue,
Na ka mbrojt prej çdo rreziku.

Emni i tij me shkronja t’ arta,
Rrin i shkruem në Histori,
Me levdatat ma të larta,

Përrjetsisht i qoftë lavdi!

Çdo shqiptar për të krenohet,
Për këtë Princ e luftëtar,
Brez pas brezi do të kujtohet,
Si Heroi ma i madh i Kombit!

Ernest Koliqi do shkruante, ndër të tjera: “Gjergj Kastrioti derdhi mund e gjak. Me mijëra Shqiptarë u flijuen në luftime të udhëhequra prej Tij. Me gjithë këtë, Shqipëria ra në një robëri disa shekuj. Por, Ai la të mbjellun në zemër të popullit, dëshirën e lirisë dhe në mendje, vegimin e një Shqipërie të bashkuar...”

Gjithashtu, Koliqi shpreh shqetësim dhe paralajmëron, që në vitin 1924: “Ne nuk i njohim forcat e fshehta brenda gjakut arbënuer”, ndërsa shton se me gjithë këtë, “duhet të bindemi se kur ndiesitë vëllezërore çlirohen nga fundi i shpirtit tonë, ato davarisin tymnajën e ndeshtrashave të zeza, duke ndezur në natën e mjerimit, hyjtë xixëlluese të shpresës!”

Kam drojë se duke marrë parasysh se si trajtohet sot Gjergj Kastrioti nga vetë një pjesë e shqiptarëve, por dhe nga “miqtë e tyre strategjikë”, Koliqi mund të ketë qenë tepër optimist në entuziazmin e tij “për hyjtë xixëlluese të shpresës”.

Uroj në këtë përvjetor të lindjes së Gjergj Kastriotit, se Zoti nuk e ka harruar Kombin shqiptar, se më në fund, me një “marrëveshje vëllaznore”, do të mund të plotësohej porosia që ka lenë Gjergji, me 17 Janar 1468, se shqiptarët brenda dhe jashtë trojeve të veta do të ruajnë besnikërisht porositë e Gjergjit, i cili shqiptarëve u dha “Atdhe Arbrin dhe shqiponjën, si simbol fluturimesh të lira dhe la një trashëgimi të çmueshme nderi e fisnikërie”.

Në këtë veprimtari shkencore, Gjergj Kastrioti normalisht, tragjeditë që ka pësuar Kombi shqiptar gjatë historisë, janë evidente, por do duhet të jenë arsye bashkimi dhe fuqizimi mbarëkombëtar dhe jo arsye përçarjeje për shqiptarët, me rrënjët e tyre të identitetit arbëror mija-vjeçar.

Në këtë 619 vit të lindjes si ky, një veprimtari si kjo, duhet të jetë një mësim, që as sot dhe as mot të mos humbet as të mos harrohet drejtimi as rruga që njerëzit e madhe të Kombit shqiptar, si Gjergj Kastrioti i kanë përcaktuar Kombit tonë.

Sot, në këtë datëlindje të tij, 619 vite më pare, me 6 maj 1405, shekuj më parë, Gjergji i Madh jep kushtrimin, duke bërë thirrje për rrugën që duhet të ndjekin sot shqiptarët, para se të jetë nesër tepër vonë!

Lavdi për jete Kryetrimin tonë, Gjergj Kastrioti!

Përgatitur nga FRASHËR RACAJ,

Kryetari i Lëvizjes për Shqipërinë e Bashkuar



Gjergj Kastrioti përjetësohet në Gjakovë

Me datën 4 maj 2024 ora 12.00 në Gjakovë, u inaugurua monumenti i Gjergj Kastriotit – Skënderbeut në mes të një pjesëmarrje mjaft e madhe nga gjithë trojet Arbënore: Nga Arbëreshet në Italia, Shoqata "Vatra" nga Stambolli Turqia, Shka "Rapsha" nga Malësia e Mbishkodrës, Sh A "Dukagjini" Shkodër, Shka "Aromë Labërie", Patriotët intelektualë e të burgosurit Politikë nga Ilirida, Estrada e muzikës kombëtare: Shkurte Fejza, Ilir Shaqiri, Nikollë Nikprelaj, Kastriot Tusha, Enkelejda Arifi, Selami Kolonja, Kristë Lleshi, Fatime Kalimashi, Malësorë Prenkoçaj e të tjera e të tjera personalitete të shquara nga vendi e diaspora.

Nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini" mori pjese Ndue Sanaj, Gjergj Leqejza, Kole Çardaku e File Moshqeti.

Të pranishmit i përshëndeti Kryetari i Komunës së Gjakovës Ardian Gjini, ish Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush Harajdinaj e të tjerë pjesëmarrës.

Pastaj u kalua në një koncert me artistët më të shkëlqyer të trojeve Arbënore

Në ora 13.00 u zbulua monumenti i Gjergj Kastriotit, me duartrokitje të pandërprera gjatë ...

Me këtë rast, poeti Ndue Vatnikaj u frymëzua aq shumë, sa menjëherë krijoi poezinë me titull

SOT PO VJEN GJERGJI N'GJAKOVË

Hej Kosovë të bekoftë Zoti!
N' Gjakovë erdh Gjergj Kastrioti,
Përmbi kalë me shpatë në dorë,
-“Mirësetëgjeta –thotë-Gjakovë!

Krenari e shqiptaris,
Djep i mëndjes e i trimëris,
Je legjendë në histori,
Ndaj kam ardhë të rri me Ty”.


Ndizet festa anëmbanë,
Krejt Gjakova ngrihet në kamë
I hapë krahët e del e t'pret,
Si kryetrim e sikur mbret.

-“Mirësevjen Gjergj Kastriot,
N'mes nesh je për jetë e mot,
Dritë e diellit je për ne,
O Kryetrimi Skenderbe”!...

KOLË ÇARDAKU



© Shkëlzen Rexha



Zona veriore e Shqipërisë me pasuri turistike ende të pashfrytëzuara

Shqipëria arriti të tërheqë vitin e kaluar një shifër rekord turistësh, prej më shumë se 10 milionë, ndërkohë që këtë vit synon rritjen e këtij numri në rreth 15 milionë. Siç njofton korrespondenti i Zërit të Amerikës, Pëllumb Sulo, ekspertët e fushës mendojnë se vendi ka ende shumë potenciale turistike të pashfrytëzuara, sidomos në zonën malore në veri të vendit, por nevojiten investime për të përmirësuar infrastrukturën rrugore, sinjalistikën turistike, shërbimet publike dhe sigurinë e lëvizjes së turistëve përgjatë shtigjeve malore.

Ekspertët e ekonomisë dhe turizmit pohojnë se Shqipëria ka ende kapacitete të pashfrytëzuara në fushën e turizmit, për të pritur një numër edhe më të madh turistësh se vitin e kaluar, kur u regjistrua një shifër prej më shumë se 10 milion vizitorësh.

Sipas profesorit të ekonomisë në Universitetin e Shkodrës, Gentian Memës, ndërsa zona bregdetare në jug të vendit po shkon me shpejtësi drejt plotësimit të kapaciteteve të veta turistike, vëmendje duhet t'i kushtohet zonës veriore, e cila ka potenciale të mëdha turistike thuhet se pa shfrytëzuara, sidomos në drejtim të tur-

izmit malor dhe atij kulturor, që ndryshe nga turizmi bregdetar është gjithëvjeter.

“Potencial në zhvillim janë zonat tashmë të njohura siç është Thethi, Vermoshi, Lëpusha. Por edhe Bregu i Liqenit të Shkodrës dhe Velipoja sidomos, janë destinacione që kanë potencial rritjet të konsiderueshëm. Por, pa lënë pas dore destinacione që, për momentin, ndoshta nuk janë shumë të zhvilluara, por që kanë mundësi për të zhvilluar sidomos turizmin malor, ku mund të përmend zonën e Kelmendit”, thotë ai.

Në këtë fazë të zhvillimit të turizmit, thotë profesor Mema, shteti duhet të luaj rolin e vet në drejtim të mundësimit të zhvillimit të biznesit turistik në këto zona, përmes ofrimit të infrastrukturës së nevojshme, pastrimit, ndriçimit publik dhe të gjithë elementëve të tjerë të nevojshëm për një turizëm të qëndrueshëm.

Mes zonave turistike me potencial të lartë zhvillimi në sektorin e turizmit është edhe Bashkia “Vau Dejës”, një territor që

gjendet mes Shkodrës, Pukës dhe Tropojës. Specialistja e sektorit të turizmit në Bashkinë Vau Dejës, Entela Kolaj, thotë se kanë qenë vetë turistët e aventurës ata që, për herë të parë, e kanë promovuar këtë zonë në mediat botërore.

“Liqeni i Komanit, Liqeni i Vaut të Dejës dhe Lumi i Shalës nuk kanë nevojë të promovohen më sepse, jo vetëm turistët e huaj dhe vendas, apo mediat botërore, po na promovojnë përditë. Ajo që ka nevojë Bashkia e Vau Dejës janë tashmë investimet. Kemi nevojë për investime. Sigurisht, rruga është një nga problemet e jashtëzakonshme. Unë i kam cilësuar shpesh 32 kilometrat rrugë nga Vau i Dejës deri në Koman si rrugë tejet të amortizuar”, thotë ajo.

Dy vite më parë u premtua nga qeveria dhënia e fondit për rrugën e Komanit, një rrugë shumë e rëndësishme jo vetëm për sektorin turistik që po zhvillohet me shpejtësi në këtë zonë, por edhe për jetën

vijon në faqen 15

21 vjetori i themelimit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”

-21 VJET PROMOVIM VLERASH -

Me datën 11 maj 2024, në sallën “Mikel Koliqi”, me muzikë me motive dukagjinase në sfond filloi veprimtaria festive kush-tuar nxënësve të dalluar të klasës së IX dhe maturanëve dukagjinase, në kuadrin e 21 vjetorit të themelimit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, e cila u themelua me vendim të gjykatës së shkallës së Pare në Tiranë, nr. 666, datë 13 maj 2003 dhe eci me moton “Mos pyet çfarë beri Dukagjini për mua, por çfarë bëra unë për Dukagjini”, nen drejtimin e Kryetares së Këshillit të Shoqatës, zonjës Dukat Bregu.

Nderuan ketë veprimtari:

N/Kryetarja e Bashkisë Shkodër, zonja Teuta Qyteza;

Përfaqësues të Shoqatës “Martin Dreshaj”, me qendër në Pejë, me kryetarin e saj, z. Ukshin Jashari

Kryetari i Lëvizjes për Shqipërinë e Bashkuar, z. Frashër Racaj

Kryetarja e shoqatës kulturore “Xhumbleta e Alpeve Shqiptare”, zonja Rita Shkurtaçaj

Maji muaji i luleve, 21 vite më parë Dukagjinit dhe Shkodrës, i fali një lule, e cila ndër vite lëshoj rrënjë dhe shtat.

Dukagjini, i dekoruar me urdhrin “Nderi i kombit”, konkretizoj misionin promovues të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, fal dashurisë, urtisë dhe bashkëpunimit të Kryesisë me dukagjinast anë e mbanë botës.

21 vite promovim vlerash, 21 vite dritare e hapur, 21 vite kampion Paqeje.

Në emër të Kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, për jetën 21 vjeçare të Saj, paraqit paa jush arritjet kryesore, N/kryetari i saj, z. Kolë Çardaku.

Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me vendim nr. 266, date 15 shkurt 2022 vendosi: Të krijohet simboli i nderimit “Mirënjohja mësuese Kushë Micja”, me të cilën do të nderohen mësuesit, nxënësit e studentet dhe ky titull jepet me vendim të veçante të kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”.

Kush ishte Kushë Micja?

Për ketë figure kanë studiuar e shkruar plote personalitete të fushës së shkollimit dhe në mes tyre Hamdi Bushati, Simon Rrota, Njazi Kazazi, Gjush Sheldia, Ludovik Shllaku, gazeta e Diasporës, Luigi Shyti e të tjerë e të tjerë dhe të gjithë janë në një mendim, se Kushë Micja ishte e para femër, që hapi shkollën femërore në vitin 1859.

Drejtesja e kësaj veprimtarie, lexoi emrat e nxënësve të dalluar të klasës IX:

Shkolla 9 vjeçare “Mehmet Shpendi”, në Breg Lumi

- 1-Lisjano Pepniku,
- 2-Emanuel Fusha,

Shkolla 9 vjeçare në Pult-Shosh

- 1-Arsida Koçeku,

Shkolla 9 vjeçare “Vasil Shanto”, në Vrakë

- 1) Donald Marku
- 2) Angjela Marku

Shkolla 9 vjeçare “Tring Smajlja” në Grude të Re

- 1-Martina Rrgalla,

Shkolla 9 vjeçare “Dede Gjon Luli” në Hot të Ri

- 1- Andrea Kola,
- 2- Aldo Malshyti,

Shkolla 9 vjeçare në Bardhaj

- 1) Nevila Shkrepaçaj,
2. Silvana Kamdaçaj

Shkolla 9 vjeçare “Branko Kadia” në Shkodër

- 1-Kristina Ndou,
- 2-Estela Shpella,
- 3-Adriana Kroni,

Shkolla 9 vjeçare “Edith Durham” në Shkodër

- 1-Nosh Dardhaj
- 2- Ermelinda Dardha,
- 3-Tome Nika
- 4-Artenisa Nika,

Shkolla 9 vjeçare “Zemra e Krishtit” në Shkodër

- 1-Emanuel Sukaj,
- 2-Artea Lamthi,
- 3-Sonia Kulla,
- 4-Gerta Gjeloçi,

Shkolla 9 vjeçare “Dëshmorët e Prishtinës”, në Shkodër

- 1-Ritvan Pishinza,

Shkolla 9 vjeçare “Cor Jesu”, në Shkodër

- 1-Amarildo Pylla,
- 2-Lorenzo Dajcaj
- 3-Florjan Deda,
- 4-Rosela Gropaj,

Shkolla 9 vjeçare “Miqësia” në Shkodër

- 1- Greisi Kakçuku, ;
- 2- Lorenc Çallaku,

Shkolla 9 vjeçare “Maria Ndihamëtare”, në Shkodër

- 1- Laura Shkoza
- 2-Andrea Vata,
- 3-Oksana Boka,
- 4-Emanuel Shulza,

Shkolla 9-vjeçare “Martin Camaj”

- 1 -Sirodela Guri,
- 2 -Leandro Nika,
- 3 -Mateo Gilaj,

- 4 -Klaris Zhuri,
- 5 -Jonila Kullashi,
- 6 -Megi Shkambi,
- 7 -Sonila Molla,
- 8 -Klevis Suti,
- 9 -Erjon Kodra,
- 10 -Kolin Rrahi,
- 11 -Emanuel Shpatina,
- 12 -Salvador Bishaj,
- 13 -Andrea Lazri,
- 14 -Andrea Martinaj.

Bosco në Shkodër

- 1-Eugen Shkëmbi
- 2-Gladiola Shpati
- 3-Serxho Shpati
- 4-Xhozi Shpati
- 5-Desara Nika,
- 6-Marina Grimaj,
- 7-Elena Çobaj,
- 8-Arber Plepi
- 9-Melisa Mirashi,
- 10-Pamela Mirashi.

Shkolla e mesme profesionale “Arben Broci”, në Shkodër

- 1-Valerio Doçaj,
- 2-Gentian Dreni.

Në emër të Kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” ju shprehim mirënjohjen për punën tuaj të dashur prindër, të nderuar mësues dhe për ju nxënës!



Drejtesja Kryetarja e Këshillit të SHAD, Dukate Bregu

Në bashkëpunim me drejtorin e shkollave të mesme u evidentuan 16 maturant me origjin nga Dukagjini, të cilët me vendim të Kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, nr. 283, date 16 prill 2024, nderohen me titullin e nderit “Mirënjohja mësuese Kushë Micja”, me motivacion:

“Për paraqitjen e shkëlqyer në mësim, për edukatën dhe shembullin e mirë. Urojmë të jeni shtysa e përparimit në të gjitha fushat e jetës. Rezultatet tuaja bëjnë krenar familjen dhe bashkësinë e Dukagjinit. Në të ardhmen qytetaria tek ju të ketë zërin e rëndësishëm e përfaqësues në institucione, për të mbrojtur vlerat qytetare e duke i ngritur edhe më lart ato! Urojmë, që këto vlera të rriten, duke treguar dashurinë për traditën dukagjinase, kulturën dhe historinë kombëtare”, të cilët janë:

Shkolla e mesme “Mehmet Shpendi”, në Breg Lumi (Shalë)

- 1-Ardit Uka,
- 2- Valentino Doçaj,

Shkolla e mesme “Maria”- Don

Shkolla e mesme profesionale pyjore, në Shkodër

- 1-Klodjana Gështenja,
- 2-Griselda Sokoli.

Ju urojmë: Urime e urime, me faqe të bardhe në jetën tuaj; vijoni të mësoni e të mësoni, se vetëm nëpërmjet shkollimit do të jeni dikush për vete, për familjen dhe për shoqërinë.

Me titullin “Mirënjohja Mësuese Kushë Micja” nderohet Kryetari i Sindikatës së Arsimit në Republikën e Kosovës, mësuesi Rrahman Jashari, e motivacion: “Mësuesi i përkushtuar dhe drejtues prej shumë viteve ku ka spikatur vazhdimisht me arritjet dhe ka sjellë ndryshimin në institucionet arsimore ku ka punuar”

Kryesia e SHAD nderon me titullin “Mirënjohja Martin Camaj” poetin e studiuesin Ndreke Dede Guri, me motivacion: “Për kontribute të shquara në evokimin e ngjarjeve historike të zonës së Dukagjinit në shekullin e XX; për pasurimin

e poezisë tradicionale, duke sjell një thesar të vyer të arkeologjisë shpirtërore, gjuhësore e etnografike të shoqërisë dukagjinase”

Me vendim të Kryesisë nr. 283 date 16 prill 2024, Shoqata Atdhetare “Dukagjini” vendosi të nderoj me disa tituj disa personalitete që me punën e tyre janë vlera të Dukagjinit:

Kryesia e SHAD nderon Don Nikë Ukgjini me titullin “Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, me motivacion: “Për kontributin e dhanë në drejtim e ri-ngritjes shpirtërore dhe intelektuale të besimtareve katolikë dhe jo vetëm, në vendin tonë dhe më gjerë si dhe në rizbulimin dhe promovimin e vlerave më të mira njerëzore, tradicionale dhe kulturore të popullit tonë; për devocionin e spikatur fetare si dhe pasionin për historinë, kulturën dhe traditën tonë kombëtare”.

Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me vendim nr. 283, datë 16 prill 2024, nderoi me titullin e larte “Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini” disa nga kadro ushtarake, që kanë punuar gjatë në zonën e Dukagjinit, ku kane kaluar një pjesë të rinisë së tyre:

Kolonel Pajtim Ribaj
N/Kolonel Aleksandër Haxhia
Major Mynyr Gojashi

Me motivacion: “Në moshën më të bukur të rinisë tuaj ja dhuruat një pjesë të saj malësorëve të Dukagjinit, të cilët ju respektuan, sepse i respektuat, aq sa edhe sot, pas shumë vitesh, që jeni larguar ju kujtojnë me respekt e dashuri. Kadro si ju i bëjnë vend vetes, por dhe mbeten të gdhendur në mendjet dhe zemrat e tyre. Faleminderit për punën dhe përkushtimin tuaj, faleminderit për lidhjen e qëndrueshme me ne malësorët dukagjinase. Ne, malësorët e këtyre anëve, dhe veçanërisht brezi me të cilët punuat, ju do t’ju kujtojnë përherë me shumë respekt”.

Kryesia e SHAD, nderon këngëtarën Viola Shqau, kryetare e seksionit të SHAD për artin e kulturën, me titullin “Nderi e Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, me motivacion: “Për kontributin e rëndësishme të dhanë në realizimin e misionit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” nëpërmjet përgatitjes e realizimit të veprimtarive të Shoqatës, në veçanti në fushën e artit e kulturës. Kontributi i saj i gjithanshëm në familje, shoqëri dhe skenën e artit mbetet shembull dhe frymëzim”.

Kryesia e SHAD, gjithashtu me këtë rast nderoj me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”:

*Zonjën Sose Dedë Gështenja (Ahi), pas vdekjes, me motivacion: “Për kontributin e palodhur 40 vjeçar në fushën e shëndetit publik. Një nga bluzë bardhat më të hershme në Dukagjin; punëtore e pasionuar për kujdesin shëndetësor të banoreve të fshatrave të Shoshit, Toplanë dhe Rrethinave të Shkodrës, luftëtare e palodhur për higjienizimin e banesave; aktiviste për pjesëmarrjen e femrës dukagjinase në veprimtaritë shoqërore, kulturore e artistike dhe për rolin e nenës në edukimin e familjes së saj”

*Zotin Kole Sukullari, kryetari i seksionit të Shoqatës për ekonominë, me motivacion: “Për kontributin e tij të rëndësishëm në realizimin e misionit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” nëpërm-

jet organizimit dhe realizimin e veprimtarive, në të gjitha hapësirat shqiptare; frymëzim për dukagjinast për t’u bërë pjesë e Shoqatës dhe për të kontribuar në përgatitjen e marrjen pjesë në veprimtaritë e saj”

* Zotin Gegë Zefi, veprimtari, me motivacion: “Për kontributin e vijueshëm në ndërtimin e veprave të mëdha infrastrukturore të atdheut, duke kenë edhe drejtues shumë kohorë; për ruajtjen dhe përhapjen e traditave kombëtare, që në moshe të re dhe deri në ditët e sotme, në veçanti nëpërmjet folklorit”

*Kryesia e SHAD, nderon me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini” dhe tre artiste, të cilët janë dhe anëtar të Shoqatës, që janë e ardhmja e folklorit Dukagjinase, dhe po japim në vijimësi një shembull shumë të mirë bashkëpunimi mes veti dhe bashkëmoshatarëve të tyre, Gentjan Gropa, Bledar Hysenaj e Noen Pjetri, me motivacion: “Për kontributin në veprimtaritë e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, për vlerat e tij artistike në interpretimin e folklorit dukagjinase”.

Përsëritet këtu veprimtari:

*N/kryetarja e Bashkisë Shkodër, zonja Teuta Qyteza, e cila u ndal shumë në vlerat e misionit të Shoqatës ... ;

*Dom Nike Ukgjini, i cili u ndal kryesisht në punën vullnetare të Shoqatës ...;

*Kolonel në pension, Pajtim Ribaj, i cili u ndal kryesisht në vlerat atdhetare të dukagjinaseve;

*Zoti Gege Zefi, i cili kryesisht u ndal për vlerat përbashkuese të Shoqatës ...



Në mbyllje përsëritet dhe Kryetari i Shoqatës, Ndue Sanaj.

Kjo veprimtari nuk mund të plotësonte misionin e saj pa kontributin e nxënësve artist te Shkollës 9-vjeçre “Dede Gjon Luli”, në Hotin e Ri, tria e famshme Suka dhe këngëtarët Gentjan Gropa e Bledar Hysenaj, të cilët me paraqitjen e tyre artistike i dhanë gjallëri artistike kësaj veprimtarie, i falënderojmë dhe ju urojme faqe-bardhësi në punën e tyre artistike e fisnike.

Me poshtë botojmë fjalën e plote;

a)N/kryetarit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”: **“Paraqitja e disa arritjeve në këto 21 vite të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” ... Domosdoshmëri e ecurisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” në vijimin e realizimit të MISIONIT të saj, në emancipimit shoqërore të bashkësisë dukagjinase ...**

Të nderuar anëtar të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”!

Të nderuar miq!

Vijmë në këtë 21 vjetor të themelimit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me realizime jo të pakta. Ne, vijmë të ecim moton e themelimit të Shoqatës “Mos pyet se çfarë bëri Dukagjini për ty, por çfarë bëra unë për Dukagjinit!”

Në këto arritje, është mendimi dhe munda i anëtarëve të shoqatës, i juaj dhe në veçanti i anëtarëve të kryesisë, për të cilën ju falënderoj dhe ju jemi shumë mirënjohës.

Ju jemi shumë mirënjohës, jo se nuk është detyra e anëtarit të shoqatës të punojë, jo se nuk është detyra e anëtarit të kryesisë të punojë, por duke qene gjithçka vullnetare, gjithçka pa shpërblim, mirënjohja është më e thellë, më e plotë, mirënjohja është më shpresdhënëse për të ardhmen e ecjes më tej të Shoqatës, në realizimin e misionit të saj.

Në arritjet e këtyre pese viteve, është dhe kontributi i pushtetit vendor, i bashkisë Shkodër, i Qarkut Shkodër, i Prefekturës Shkodër, i njëjve administrative, të cilët na pranuan për të bashkëpunuar, na kane mbështetur deri në strukturat më të larta të Shtetit, pa të cilën ndoshta disa arritje nuk do të ishin sot prezent.

Më lejoni, që me këtë rast të paraqes dy arritje:

Së pari, Kryesia e Shoqatës pasi vendosi të nxjerre gazetën e pagëzuar me emrin “Dukagjini”, e cila që nga numri i pare, në dhjetor 2003 e deri më sot nuk është ndaluar. Në këtë fund muaji del numri 247 i saj, fale përkushtimit të redaksisë së saj e drejtuar nga Prele Milani, Lazer Kodra, Suela Ndoja, Luigj Shyti dhe së fundi nga





Vallëtare nxënës të shkollës 9 vjeçare “Dedë Gjon Luli”, në Hot të Ri

Klodjana Serraji, që nga Australia e largët, SHBA, shtete të ndryshme të Evropës, dhe të hapësirave shqiptare, që nga Kosova Lindore e deri te Rrozhaja, që nga Saranda e deri te Peja e Tuzi, me plote 638 autore, me 3 587 artikuj të ndryshëm. Realizimi i botimit të gazetës “Dukagjini” nuk do të ishte arritur pa kontributin financiar të 107 dukagjinasve, me një vlerë prej 5 099

beu” dhe zoti Gjergj Leqejza e Luigj Mila nga Këshilli i Qarkut Shkodër nderohen me titullin e larte “Krenaria e Qarkut Shkodër”.

Janë përjetësuar në qytetin e Shkodrës, Atdhetari Mehmet Shpendi dhe Albano-logu Martin Camaj

në vitin 1859.

Në këtë takim ju bëjmë me dije, se në konferencën e VI të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, të mbajtur me 20 tetor 2018 u vendos ndryshimi i misionit të shoqatës dhe nga ai moment, misioni i saj është:

“Puna dhe përpjekjet që duhen bërë, krahas vijimit të njohjes së mëtejshme e promovimit të vlerave të zonës së Du-

shoqërinë. Ju jeni e ardhmja e jonë!

Shoqata Atdhetare “Dukagjini” në vijimësinë e punës së saj për promovimin e vlerave dhe emancipimin shoqëror, duke vlerësuar rolin pothuajse paralel të mësuesit me familjen, për formimin e shoqërisë ku fëmijëria është etapa e parë e saj, menduam që ti gërshetojmë këto hallka të rëndësishme, të cilat me rezulta-



Këngëtari Bledar Hysenaj, Kryetari për Lëvizjen Shqipëria e Bashkuar – Frashër Racaj, këngëtarja Viola Shqau e këngëtari Gentjan Gropa, që u nderuan me tituj nderi nga Kryesia e SHAD



N/kryetari I SHAD, Agron Hasanaj, duke i dorëzua Don Nikë Ukgjinit, titullin “Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini” Dom Nikë Ukgjini duke përshëndetur pjesëmarrësit



Kryetari i SHAD, Ndue Sanaj, duke i dorëzuar Kolonel Pajtim Ribaj, N/Kolonel Aleksandër Haxhia e Major Mynyr Gojashi titullin “Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini”

542 leke, por kryesisht të Gjergj Leqejzes, të Ndue Ftonit, të Mhill Prronit, Agron Hasanaj, Anton Kosteri, Kujtim Funiçit dhe të tjerëve e të tjerëve.

Së dyti, në këto 21 vite, janë dekoruar personalitete e figura të rëndësishme në jetën e bashkësisë dukagjinase: Albanolgu Martin Camaj, atdhetari Mehmet (Sokol) Shpendi, Profesor Kole Prela e piktori Lin Delija, me urdhrin “Nderi i Kombit”;

Zona e Dukagjinit, me urdhrin “Nderi i Kombit”; poeti Frederik Reshpja e Kantautori Mhill Çuni e këngëtarja e aktorja Rita Ndoci, me urdhrin “Mjeshtër i Madhe”, Dom Prek Ndrevashaj, me titullin “Kalorësi Gjergj Kastrioti-Skënder-

Në këto 21 vite, arritjet janë të shumta, por po ndalemi në nderimin e nxënësve të dalluar të klasës së IX dhe maturantë dukagjinase.

Një veprimtari e tillë u zhvillua, për here të pare, me datën 13 mars 2022, në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave 9-vjeçare, u organizuam takimin me nxënës të klasës IX të shkëlqyer, me teme: “Shkollimi e edukimi janë çelësi i emancipimit të shoqërisë sonë”, dhe këta nxënës u nderuan me titullin **“Mirënjohja mësuese Kushë Micja”**, mësuesja e pare dukagjinase në Shkodër, që ngriti shkollën e pare femërore në qytetin e Shkodrës,

kagjinit, për emancipimin shoqëror të dukagjinasve kudo janë, me objektivin që si qytetar të mirë e në bashkëpunim me njeri-tjetrin, të ecim përpara drejte standardeve evropiane”.

Në punën për realizimin e këtij misioni është punuar nëpërmjet veprimtarive të ndryshme, në promovime libri, nëpërmjet gazetës, e pagëzuar “Dukagjini”, në takime të ndryshme, por mbi të gjitha duhet të punohet me të rinjtë.

Ku ka më mirë se të punohet me të rinjtë e të rejtat, në veçanti në punën për të vlerësuar ata. Prandaj ky takim është planifikuar të zhvillohet, me temën: “Përparimet tua kënaqësi për prindërit, frymëzim për





Kolonel Pajtim Ribaj duke përshendetur të pranishmit

tet e deri tanishme premtojnë të ndjehemi krenar dhe ta shohim të ardhmen më me siguri. Prania juaj këtu nxënës të dalluar, prindër dhe mësues është kuptim plotë.

Po të qëndrojmë të bashkuar në këtë ecje do arrimë të mirën, të bukurën, sukseset dhe ardhmërinë. Dashuria, për jetën, urtinë, forcën dhe vendosmërinë e ka ushqyer, ushqen dhe do ta ushqejë edhe në vijim Genin tonë Dukagjinin, i cili në çdo aspekt të jetës ka qenë, është dhe do të jetë oazë jo vetëm për Dukagjinin, Shkodrën, por edhe për Kombin dhe kjo na bënë krenarë të gjithëve.

Prania e këtyre nxënësve sot, të shumtë në numër është tregues i mirë që na nxitë të gjithëve, që kësaj fidanishteje ti rrimë pranë dhe ta shoqërojmë në rritjen e tyre. Prandaj, ne vendosëm që ta organizojmë këtë takim të veçantë, që së pari këta



Z Mark Rupa, në emër të Kryesisë së SHAD, duke i dorëzuar veprimtarit Gegë Zefi titullin "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini"

fëmijë ta ndjejnë vetën të mbështetur në ecurinë e tyre. Ata nuk janë vetëm, por të mbështetur nga familja, mësuesit dhe shoqëria. Në arritjet tuaja të deri tanishëm, duhet të dashur nxënës të jeni falënderues ndaj prindërve, që ju sollën në jetë dhe ju krijojnë mundësit për të qenë të lumtur. Të jeni falënderues ndaj mësuesve tuaj, që ju ushqejnë me dije. Kur bëhen bashkë dashuria e përvoja, e prindërve dhe mësuesve me vullnetin dhe talentin tuaj, rezultatet janë gjithmonë të mira dhe ju do jeni të suksesshëm. Ju me rezultatet tuaja



N/kryetarja e bashkisë Shkodër, duke përshendetur pjesëmarrësit

na jepni garanci për të ardhmen.

Për ju mësues, urimet me të mirë, se janë rezultatet e mira të nxënësve tuaj që janë pasqyra më e mirë e punës tuaj. Për këtë krahas nxënësve, familjarëve edhe ne, Shoqata Atdhetare "Dukagjini" ju falënderon si kontribuuesit më të mirë në rritjen që garanton një të ardhme inteligjente dhe të suksesshme të trevës sonë. Këto arritje garantojnë vijimësinë e vlerave të Trevës së Dukagjini dhe integritimit e saj të suksesshëm.

Duke shikuar, sot fëmijët tanë nxënës dukagjinin të klasave të IX dhe maturante, të disa shkollave të Bashkisë Shkodër ndjehemi të lumtur. Fidanishtja jonë rrezaton plot dije dhe siguri për vazhdimësinë.

Ju drejtohem ju të dashur nxënës, duke ju thënë se ecja juaj sa po ka filluar, do jetë e gjatë dhe lodhshme. Në këtë ecje ju nuk do jeni vetëm, por jeni të shoqëruar nga prindërit, mësuesit dhe shoqëria. Shembulli i të parëve tuaj do ju përcjell dhe do ju bëjë krenarë që jeni pasardhës të Martin Camaj, Kardinal Mikel Koliqi e shkrimtari Ernest Koliqi, piktori Lin Delisë e Zef Shoshit, artistet Ndrek Lucës, Tinka Kurtit e Pjeter Gjoka, profesor Kole Prela e At' Luigj Marleka dhe shumë të tjerëve në fushat e ndryshme të jetës.

Në emër të Kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", ju urojmë që gjatë kësaj Maratone ju të renditeni gjithmonë në vendet e para.

Të dashur nxënës, mësues, prindër dhe të pranishëm vetëm së bashku jeta garohet mirë dhe bukur.

Në përfundim ju falënderojmë për praninë dhe arritjet e deritanishme!

Ju uroj bekimet e Zotit dhe suksese të mëtejshme!

b) Fjala e **mbylljes** të Kryetarit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini":

Të nderuar të pranishëm!

Të nderuar miq!

Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe ju shpreh mirënjohjen e thelle në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", për kohën aq të çmuar, që na kushtuat!

Të nderuar mësues!

Ju shpreh mirënjohjen e thelle, për punën tuaj shumë fisnike, që bëni me djemtë e vajzat tona, për t'u dhënë dituri për jetën e tyre, duke pasur me shumë kujdes porrosinë e WILLIAM A. WARD, i cili thek-



N/Kryetari i SHAD, Prele Milani, duke i dorëzua për Sose Ahi, pas vdekjes, titullin "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini", vëllait Pal Dedë Gështenja

sonte: "Mësuesi mediokër flet. Mësuesi i mirë shpjegon. Mësuesi superior demonstroi. Mësuesi i madh frymëzon ...", dhe ju frymëzoni nxënësit për të mësuar ...

Të nderuar prindër!

Ju shpreh mirënjohjen e thelle në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", për punën që keni bërë me fëmijët tuaj, duke ju dhënë edukatën e nevojshme për të mësuar, se vetëm të mësuarit i jep fëmijës dijen e nevojshme për jetën ...

Të dashur djem e vajza!

Ju shpreh mirënjohjen më të thellë, për dashurinë që keni për të mësuar! Ju na bashkuat të gjithë neve në këtë sallë, në kuadrin e 21 vjetorit të themelimit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", duke pasur për objekt kryesor nderimin tuaj dhe përsëri jo vetëm ju, por dhe shokët e shoqet tuaj paraardhës, pasardhësit tuaj ...

Lind një pyetje e thjeshtë:

E sotmja?

E sotmja është vetëm një ditë nga të gjitha ditët që do të vijmë në vijim. Por, ajo që do të ndodhë në të gjitha ditët e tjera që do të vijmë, mund të varet nga ajo që do të merrni sot përsipër, mund të varet nga ajo që do të varet, se sa do ta vlerësoni të sotmen.

Të nderuar mësues!

Të nderuar prindër!

Të dashur nxënës!

Të punoni së bashku shumë për tu emancipuar, e cila në radhe të pare arrihet nga shkollimi. Ne nuk duhet ta harrojmë, se nga jemi, por dhe duhet të dimë se ku do të shkojmë, por duhet ditur, se kush mbetet peng i kujtimeve të së kaluarës, s' ka guxim të kërkojë rrugët e së ardhmes.

Konica i madh, na porosiste: "Shumë duhet të punojmë ne shqiptarët, sot dhe për së shpejti; po më parë nga të gjitha, të shëndoshim dashurinë dhe vëllazërinë në mes tonë. Mjerimi i shqiptarëve ka qenë në tërë kohërat të kapej pas individëve dhe jo pas ideve... Historia e Shqipërisë është e mbushur fund e krye me prova të tilla të përngjashme. Të përpqemi me të gjitha forcat tona të shërojmë shqiptarët nga dashuria për individët. Ata duhet të mësojnë të duan Shqipërinë – jo t'i bëjnë qejfin këtij apo atij shqiptari".

Mendoj, se nuk ka nevojë për shume komente. Por duhet të kemi parasysh: "Tri gjera nuk mund të kthehen kurrë mbrapsht: Fjala e thënë, shigjeta e lëshuar dhe



Një nga themeluesit e SHAD, Prele Shytani, duke i dorëzua mësuesit Rrahman Jashari, titullin "Mirënjohja mësuese Kushë Micja"

e kaluara", prandaj duhet mësojmë shumë dituri, që të mos gabojmë.

Të lexojmë shumë, e them këtë, se nuk është e lehtë të mësosh për të lexuar. Një personalitet theksonte për leximin: "Njerëzit e rëndomtë dine pak se sa kohe dhe ç' përpjekje i duhen njeriut për të mësuar leximin. Kam tetëdhjetë vjet që lexoj dhe ende nuk e mësova ...".

Duhet ditur, se nuk do të thotë gjë, se banon në qytet dhe të quhesh qytetar. Jo, se qytetar quhet ai person, që njih detyrën e punon për zbatimin apo kryejnë e saj ... quhet ai person, që njih të drejtat e veta dhe bën përpjekje për ti plotësuar, për ti siguruar. Pra, ai person që ka këto dy kërkesa në jetën e tij, pavarësisht se ku banon, në mal, në fushë, në qytet apo tjetër kund, quhet qytetar, në të kundërt nuk quhet qytetare ...

Më lejoni të falënderojmë ata dukagjinin, që na mundësuan të përgatisim e zhvillojmë këtë veprimtari: nga dukagjinasiit me banim në Kanada: **Arben Pepa, Prek Gjonaj, Beskin Arinaj, Sokol Sterbyç, Nikoll Gerla e Noc Bregu; dukagjinasiit me banim në Nju-Jork: Dedë Prendaj, Gjin Markaj dhe Ndoc Sukaj...**

Nga kjo veprimtari ju drejtohem:

1) Mësuesve, të shkolluarve dukagjinin dhe më gjerë të bëhen pjesë e shoqatës Atdhetare "Dukagjini", se do të gjejnë veten dhe jo vetëm kaq, por do të jepni kontributin tuaj shumë të çmuar në emancipimin e bashkësisë sonë aq të nevojshme, së pakut të largohemi nga ndjenja raciste ndërveti, ta pranojmë njeri-tjetrin siç jemi.

2) Biznesmenëve dukagjinin, emigrantëve dukagjinin kudondodhur të bëjnë përpjekje, që nga të ardhurat e tyre, të kursejnë pak, për të mundësuar në realizimin e veprimtarive të shoqatës, se pa këto nuk mund të përgatitet e zhvillohet asnjë veprimtari, të dali as gazeta, me emrin e shtrenjtë "Dukagjini", e cila me kontributin tuaj ka 246 muaj që del pa ndërprerje dhe në këtë muaj del numri 247, e vetmja gazete që del në qytetin tonë, Shkodrën.

Ju faleminderit dhe mire u takofshim në veprimtari të tjera!

ROZA PJETRI,
N/Kryetarja e SHAD,
Shkodër, me 11 maj 2024

ERNEST KOLIÇI - MENDJA E NDRITUR QË E PËRBUZI VENDLINDJA

Ernest Koliqi ishte poet, romancier, eseist, përkthyes, gazetar, dramaturg, albanolog, mësues dhe botues shqiptar. Cilësohet themelues i tregimit modern shqiptar.

Është një nga figurat më elitare të kohës në të cilën jetoi.

Lindi në Shkodër, në pranverë të vitit 1903 i biri i Shan Koliqit nga lisi i gjakut i tij kishte origjinën prej Lotajve të Shalës së Dukagjinit, e rënë në krahinën e Anamalit rreth vitit 1700 së pari, e pastaj në Shirokë. Prej një të pari i mbeti nofka Koliqi, të cilës iu vendos prapshtesa-iqi prej tregtisë të vazhdueshme me Malin e Zi.

Ishte i dyti ndër fëmijët, mbas Mikelit - që do të bëhej i pari kardinal shqiptar - dhe mbas tij vinin Leci, Guljelmi, Margerita, Viktori dhe Terezina. Pas mësimeve të para në Kolegjin Saverian të Jezuitëve, i ati e dërgoi për të studiuar në Itali më 1918. Prandaj me plot bindje mundemi të besojmë dhe të kuptojmë prirjet e tij pro italiane, pro perendimore. Të mos harrojmë se, koha e shkollimit të tij përkon me rënjen e Perandorisë Osmane dhe luftën e parë Botërore prandaj edhe kultura Evropiane ishte e vetmja shpresë për klasën intelektuale shqiptare të kohës.

Studimet i fillon në kolegjin jezuit "Cesare Arici" në Breshia dhe pastaj në Bergamo. Kthehet në Shqipëri pasi që gjendja politike futet në një farë qetësie pas Kongresit të Lushnjës, mëson shqipëri dhe falë njohjes me Luigj Gurakuqin, njihet me elitën dhe rininë premtuese të kohës. Më 1921 mbahet një konkurs për himnin kombëtar, ku Ernesti merr pjesë me një poezi, e cila fitoi çmimin e parë, të dhënë nga juria e përbërë prej P. Gjergj Fishtës, Fan Nolit, Mitat Frashërit e Luigj Gurakuqit. Në mars-prill merr pjesë përfaqësues i shoqërisë kulturore "Rozafa" dhe së bashku me Pader Anton Harapin, në takimin që formoi grupimin "Ora e Maleve". Mbas Lëvizjes së qershorit, Luigj Gurakuqi e thërret në Tiranë si sekretar personal bazuar në njohjet e tyre, por edhe formimin e larte intelektual. Bashkëpunoi me shoqërinë "Bashkimi" të themeluar prej Avni Rustemit. Kalon më pas në detyrën e sekretarit, në Ministrinë e Brendshme, kur ministër ishte Kolonel Rexhep Shala.

Lëvizjet e ashpra politike të kohës e detyrojnë të largohet nga vendi, ku studioi gjuhën dhe kundron letërsinë serbo-kroate. Qëndron për dy vjet në Tuzla të Bosnjës me shumë nga krerët e maleve. Në Zara të Dalmacisë botoi edhe përmblendhjen e parë me novela, më 1929, ku ishte edhe miku i tij në ideale e në punë gjuhe, Mustafa Kruja. Kthehet në atdhe dhe nis punë në detyrën e mësuesit, në Shkollën "Italiene Tregtare", në Vlorë dhe mandej në Gjimnazin e Shkodrës (1930-'33). Nis të verojë ndër bjeshkët e Dukagjinit ato vite, ku përpos ndodhive

shënonte edhe kangët e buta - siç i thonë në Dukagjin këngëve erotike - kujtime, të cilat do t'i shkruante dhe botonte mbas '70 me pseudonimin "Hilushi". Në atë kohë miku i tij, Mustafa Kruja i kërkon me mbledhë librat e bibliotekës së tij, të cilat qenë shpërndarë ndër françeskanë e jezuitë mbasi lëshuan Shqipërinë në dhjetorin e 1924. Më 1933 jep dorëheqjen nga mësimdhënia, për të nisur studimet universitare në Padova. Në po të njëjtën të përkohshme, më 1935 do të zbulohet



Migjeni me vjershën "Të lindet Njeriu", me nxitje të Koliqit. Më 1936 e emërojnë Lektor të Shqipërisë në katedrën e Albanologjisë, të drejtuar nga gjuhëtari C. Tagliavini. Më 1937 doktoron po në Padova me tezën "Epica popullore albanese" ("Epika popullore shqipe"), falë mbledhjeve që kishte bërë Pader Bernadin Palaj, tezë doctorate, e cila u vlerësua nga shumë albanologë si N. Jokli, M. Lambertz e të tjerë. Transferohet nga Padova në Romë tetorin e 1937, në funksionin e lektorit të shqipërisë. Më 1939 hapet në Universitetin Shtetëror të Romës Selia e Albanologjisë, ku Koliqi emërohet ordinar dhe qëndron i tillë derisa doli në pension.

Ndërprerja e vetme disi e gjatë, që kur u emërua Ministër i Arsimit, në vjetët 1939-'41. Kjo është ajo pjesë e jetës së tij, e cila do ti kushtonte shumë shtrenjte Koliqit.

Pas luftës së Dytë Botërore dhe vendosjes të Diktaturës në Shqipëri, pothuajse i gjithë truri i kombit emigrojnë ose u burgos. Jeta e tij vijoi në mërgim, por ai shpirtin e zemrën e kishte në Shqipëri dhe për gjuhën kulturore, letërsinë dhe Kombin Shqiptar do të jepte një kontribut të çmuar.

- Më 1932 del nga botimi vëllimin e parë të antologjisë, me titull "Poetët e mëdhenj të Italisë", me parathënie të Fish-

tës, një antologji me 280 faqe, që u përdor menjëherë tekst për letërsi në gjimnazin klerik të Shkodrës dhe përmban katër poetët më të mëdhenj të Italisë: Danten, Petrarkën, Arioston e Tason.

Më 1935, boton vëllimin e dytë të antologjisë "Poetët e mëdhenj të Italisë", me parathënie nga Tagliavini, ku përfshiheshin vjersha të përkthyer të katër italianëve të tjerë: Parini, Monti, Foskolo, Manxoni. Personalisht çmonte Giosuè Carducci e Giovanni Pascoli.

Më 1961 nis të përkthejë Lahutën e Malcís në italisht, përkatësisht këngën XXVI, më tej më 1971 përktheu këngët XII-XIII-XIV dhe XV;

Nisi të botonte nga viti 1954 deri më 1961 studimin krahasues "Dy shkollat letrare shkodrane - e Etënve jezuitë dhe e Etënve françeskanë". Në këtë studim të tij vërehet përpjekja për të hartuar një histori të mirëfilltë të letërsisë shqiptare, jashtë ngjyimeve ideologjike. Në Firenze boton vëllimin "Poesia popolare albanese" ("Poezia popullore shqiptare") me të cilën paraqitet studiuesi i merituar i traditave artistike dhe folkloristike të atdheut të tij.

1959 - Boton vëllimin "Kangjelet e Rilindjes" ("I canti della Rinascita"), me përkthimin në italisht, kushtuar arbëreshëve të Italisë, me të cilën i nxit ata të ruajnë gjuhën e traditat dhe të kenë besim në

pavdekësinë e fisit. Boton studimin "Gabriele D'Annunzio e gli Albanesi" ("Gabriel D'Annunzio dhe Shqiptarët"). Në vitin 1963 - Boton "Antologia della lirica albanese" ("Antologjia e lirikës shqiptare") nëpërmjet të cilit për herë të parë paraqiten në një gjuhë evropiane përkthimet e lirikës më të mira të autorëve shqiptarë të vjetër e të rinj, që theksohen edhe autorët kosovarë, me qëllim që të njihen më mirë.

Në vitin 1965 - Del në dritë "Albania", një monografi italisht, botuar në "Enciclopedia dei popoli d'Europa", Milano, me të cilën paraqet një pasqyrë të gjerë mbi Shqipërinë si në pikëpamjen gjeografike, ashtu edhe letrare e historike.

Në Publicistike themeloi dhe drejtoi revista, në të cilat u botuan dhe trajtuan letërsia e kultura shqiptare si: "Ora e Maleve", "Shkëndija", "Shëjzat", bashkëpunoi me revistat "Hylli i Dritës" e françeskanëve, "Leka" e jezuitëve, "Përpjekja shqiptare", "Minerva", "Besa" dhe shumë të tjera.

Koliqi ishte nga gjaku i Lekëve të Dukagjinit, ishte biri i Shkodrës, ishte krenari e kombit të vet. Ai nuk i mbeti borxh askujt, por ne dhe klasa politike Shqiptare i kemi borxh atij mendjendrituri.

Me poshtë do sjell një ligjëratë, që po aq ka një vlerë atdhetare të rrallë, letrare po e po, por aq fort ka dhe një vlerë gjuhësore në gegnishten moderne të një Ernest Koliqi, ku stili letrar dhe vlerat e çmueshme gjuhësore e shndërrojnë këtë ligjëratë vërtetësisht në "gjashtëdhjetë e dy strofa të një poeme".

Rruga Bogë - Theth është përruar më 17 tetor 1938. Një përruar dinjitoz e modern madje, ku do të merrnin pjesë edhe ministri i Ekonomisë Kombëtare, Rrok Gega, i cili pret shiritin e përruarit të rrugës, por dhe Patër Gjergj Fishta i madh.

Një ligjëratë, që ka vlerë të rrallë letrare, e mbajtur prej Ernest Koliqi me rastin e inaugurimit të rrugës Boga - Theth, më 17 tetor 1938.

- Qitja e kësaj udhe prej Shkodrës në Theth që një sajim gjenial e guximtar. Zakonisht vetëm arsena ekonomike e tregtare shkaktojnë punimin e rrugave që lidhin visin me vis. Kso here sidomos një arsye rendi shpirtënuer nxiti qeverinë dhe popullin në të kryemit e veprës së madhe, që hyn sot lumnisht në rradhën e veprave ma të shqueme, fillue e mbarue nën regjimin e Mbretit Zog. Nji nevojë e shpirtit, me kërkue një ndër fytyra ma të freskëta dhe të hijeshme të Shqipërisë, drejtoi shestet e ingenjerave dhe kazmën e puntorve. Gjashtëdhjetë kilometrat e kësaj udhe janë si gjashtëdhjetë strotat kumbore të një poemi ku ambëlësia e një lirizmi të hollë shkrihet me madhështinë e një epike të fortë.

Në këtë mengjes të kulluet vjeshte, gjatë udhëtimit mbi këtë rrugë të re, a nuk na u dikue ndër sy, a nuk na rrëshqiti në shpirt drita edhe muzika e një poemi të pashkrues qm këndon tokën shqiptare?

Tue u nisun, valët e liqenit të Shkodrës na përshëndetën me një buzëqeshje të kalthërt. Hyme në Fushën e Prronit të Thatë dhe lamë në krahë të rrëmakët fshatin Marshej, dikur i quejtun Cinna, vend i rrebët kullash ilire, pushtue ma vonë nga Rromakët, që lane aty teprica ledhesh, pyrgjesh e vorrezash. Djerret e papreme të Fushës së Prronit të Thatë na shkretnuen të pamit; gjithashtu edhe vargu i maleve t'egra, të thepisuna e të çveshuna, që na duelen përpara si me na pritë udhëtimin, i a shtuen syve etin e bukurisë. Por, tue u ngjitur kah Boga, majet e maleve filluen të marrin ngjyra ma të kandshme ndër avuj mëngjesorë. Kaluem, nëpër Bogë, motit shtrat i një liqeni që erdhi tue u shterrë e tue u tha, grykë qindrese ku Kelmendasi dermuen më 1623 një ushtri tyrke kah zmbrapej prej Malit të Zi. E rruga hyni në pyell edhe muer guximtarisht përpjetjen. Qafa e Tërthores asht një ndër dyer ajrore të Dukagjinit, një derë e naltë 1600 metra mbi rrafsh të detit. E kapërcyem me makina të shpejta edhe që gjindemi mu në zemër t' Alpeve shqiptare. Dy orë të vetme na kanë mjaftue për t' arrijtun në këtë copë parrizi të mëshëfunt

SHOQËRIA, TURBULENCAT DHE PATOLOGJITË QË CËNOJNË EKUILIBRIN E BRENDSHËM TË SAJ

Me sociologun Gëzim TUSHI, “Mjeshtër i MADH”, “Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut”



FRAN GJOKA

- Shqipëria po përjeton një situatë të dhimbshme kriminale, ku del në pah një dhunë e pashpjegueshme ndaj femrës. Si mund ta konsideroni ju këtë situatë dhe cilat do të ishin rrugët për ta kapërcyer këtë gjendje?

- Realitetet sociale në shoqërinë shqiptare kanë kohë që janë të inonduara nga shumë dukuri shqetësuese, të cilat tregojnë dobësimin deri në nivele kritike të shëndetit, kohezionit dhe funksionalitetit të saj. Për nga gjerësia e shtrirjes dhe intensiteti i shfaqjes së disa dukurive, si dhuna, krimi, neurotizmi social, konfliktet në familje, fenomeni i bullizmit në shkollë, divorci në zgjerim dhe dekompozimi i strukturës dhe funksionalitetit në shumë familje, zgjerimi i përdorimit të drogës, alkoolit dhe substancave psiko-trope nga të rinjtë, rritja e krimit minor

dhe abuzimi seksual në moshat e reja, trajtimi i keq i të moshuarve në familje dhe braktisja e tyre në vetmi, bashkuar këto me patologjitë e politikës shqiptare dhe nivelet alarmante të korrupsionit e bëjnë tablonë të dyshimtë dhe fare pak optimiste. Në këtë tablo të problemeve të shumta sociale, më të cilat po përballët shoqëria shqiptare, në mënyrë evidente dhe shumë shqetësues paraqiten dhuna dhe krimi në familje. Sidomos dhuna dhe krimi mbi gratë për shkak të dominimit të koncepteve maskiliste dhe modeleve autoritariste, të cilat jo vetëm nuk janë zbutur, por përkundrazi janë në një proces agravimi të akseleruar, duke e bërë situatën e familjes dhe statusin e gruas shumë të prekshëm. Në jo pak raste, për shkak të dhunës permanente fizike, psikologjike, verbale dhe emocionale që ushtrojnë meshkujt mbi femrat, burrat mbi gratë e kanë bërë familjen “burg për gratë”. Nëse në mënyrë sintetike dhe sociologjike do të përkufizonim situatën e dhunës mbi gratë në familjen dhe shoqërinë e sotme shqiptare, padyshim do të themi se me këto përmasa alarmante në gjerësi, thellësi dhe intensitetin me të cilin ajo shfaqet, duhet konsideruar si një “betejë e pafutur” nga gratë. Burimet dhe gjeneratorët e vazhduar e të “pashtershëm” të dhunës ndaj grave janë disa faktorë me natyrë të ndryshme fizike dhe metafizike, konceptuale dhe materiale, historike e kulturore, biologjike e psikologjike. Sikur të tentonim të bënim diagnostikimin e këtyre shkaqeve në mënyrë enumerative, do të na duhej shumë kohë dhe investim më strategjik. Por në kuadrin e sensibilitetit për gazetën e nderuar “Nacional”, mund të themi se të gjithë këta faktorë kanë secili peshën e tyre në ekzistencën e dhunës mbi gratë. Një gjë është e sigurt: ne jemi para nevojës që pasi

kemi bërë këtë diagnostikim të shkaqeve të dhunës mbi gratë, duhet të mendojmë, të ofrojmë dhe propozojmë edhe “terapitë” e duhura politike, psikologjike, kulturore e materiale. Në këtë kontekst, gjej se paradigma që është instruktive, në këtë rast ka të bëjë dhe lidhet ngushtë me punën që duhet bërë nga institucionet e edukimit dhe formimit human e qytetar, sikurse janë familja, shkolla, media, institucionet fetare. Por natyrisht edhe ato të parandalimit dhe ndëshkimit të dhunës mbi gratë, e cila, sikurse ka thënë me të drejtë Hillari Klinton në Konferencën e Pekinit në 1995, nuk duhet konsideruar si difekt kulturor, por si veprim i hapur dhe i pastër kriminal, i cili duhet trajtuar dhe ndëshkuar si i tillë. Unë mendoj se bashkimi kompakt i këtyre dy hallkave të procesit të luftës kundër dhunës mbi gratë, domethënë i punës së institucioneve të formimit dhe edukimit me ato të ndëshkimit, kthimi i tyre në një strukturë operacionale kompakte, do të ishte rruga e duhur dhe ajo që imediatisht kërkohet për të mbrojtur gratë tona nga patologjia e dhunës, për t’u garantuar atyre liritë dhe të drejtat njerëzore, duke shmangur kështu paragjykimet e korracuara, arkaike e bashkë me to edhe arketipet maskiliste të trashëguara nga e kaluara dhe që akoma “frymojnë” edhe në ditët tona. Gratë duhet të luftojnë kundër çdo shfaqje mizogjene në familje, shkollë, vendin e punës, politikë, komunitet, familje e kudo që shfaqet. Ato janë në kohën e tyre dhe kanë të drejtë të trajtohen me dinjitet si qenie njerëzore të barabarta. Identiteti seksual i tyre nuk ka pse të jetë “mallkim” për to. Përkundrazi, ky identitet në një shoqëri të emancipuar mund të kthehet në një lloj të veçantë të “privilegjit social”, pikërisht për shkak të gjinisë së tyre. Dhe më në fund,

gratë nuk duhet të heshtin ndaj dhunës, përkundrazi ato duhet ta denoncojnë atë pa hezitim. Heshtja është kundër tyre dhe në çdo rast ajo bëhet aleat i dhunës mbi gratë. Ndoshta kjo kërkon edhe një sulm qytetar dhe të qytetëruar edhe kundër indiferencës sociale, që shfaqet shpesh në shoqërinë tonë, e cila ushqehet nga koncepti semplast, i cili dhunën mbi gratë nuk e konsideron problem. Madje e konsideron si problem anësor dhe “çështje rutinore”. Një qëndrim social e qytetar më i angazhuar do t’i ndihmonte gratë në kauzën e tyre të përbashkët kundër dhunës në familje e shoqëri.

- Ngjarja në Shkodër ka tronditur gjithë opinionin publik shqiptar. Cili është mendimi juaj, si profesionist, ndaj shkaqeve dhe arsyeve që çuan në këtë krim?

- Ngjarja e ndodhur para pak ditësh në Shkodër është tejet tronditëse dhe makabre. Në historinë e ngjarjeve kriminale është ndoshta më e rënda, sepse kemi të bëjmë me një kompleks kriminaliteti, ku bashkohet paradoksalisht vetëvrasia me krimin. Këto ditë, me të drejtë, kjo ngjarje ka kapur apogjeun e sensibilitetit social dhe reagimit mediatik. Por shpesh, në analizat e ngjarjes, të shkaqeve dhe përgjegjësiive individuale e sociale, në interpretimin e faktorëve janë shfaqur shumë pasaktësi, njëanshmëri e sensibilitete të deformuara. Që jo vetëm nuk të lejojnë të kesh optikë të qartë për shkaqet, por edhe që japin mesazhe të gabuara sociale për rrethanat dhe përgjegjësitë. Ngjarja është e rëndë dhe perceptimi i saj ka qenë tejet tronditës për familjet e viktimave, por dhe opinionin publik. Por nëse duam që të bëjmë analizë objektive dhe të nxjerrim mësimë

banue prej Ilirëve të fundit.

Na sot kemi ardhun si krushqit në darsëm, kemi ardhun për t’ia hjekë duvakun një nusjeje të mrekullueshme, kemi ardhun për t’ia zbulue botës bukurin e Thethit qi për mija vjetsh mbet e fshehun dhe humbun.

Çoni shikimin kah kunora qi rrethon kët luginë të pashoqe dhe veni re se si vijat arkitektonike të tyre shuejnë at nevojë ngushllimi qi djeg sytë t’anë. E shuejnë sepse këto trajta shkambijsh kanë dishka në vetvete qi u ngjet bukuris së motrave t’ona, fytyrës burrnore të vllazënve t’anë. Gjasime misterioze vrehen ndërmjet brumit të gjallë në të cilin u trajtuen fytyrat t’ona shqiptare me shkamb të qindrueshëm të këtyne maleve qi thirren me emna trimijveçarë. Këtu, nën çdo hije lisi, pushon një orë shqiptare; n’ujin e çdo kro-

ni këndon një Zanë ilire. A nuk ndjeni në kët heshtje të madhnueshme, në heshtjen e naltë ndërmjet maleve e të qiellit rektimet e një zemrës së madhe? Asht zemra e Iliris qi rreh ç’prej thellësis së moteve, një zemër vigane qi dyzet qindvjeta nuk kanë mujtë ta mplakin.

O popull fisnik i maleve!

Na njerzit e shkollës qi mbi makina të shpejta erdhëm në dy orë të vetme prej qytetit në këtë skaj deri tash të panjoftun t’atdheut, t’a kemi pru me vete një lajm të mirë. Jemi lajmtarët e qytetnis së re shqiptare.

Gjatë kësaj rruge qi krahi i yt çeli nëpër pyje e në shkamb të gjallë, kanë m’u ngjitur mjekët e mësuesit për të cilët ti ke aq fort nevojë. E bashkë me ta ndiesija e njij vllaznimi nëmën të Shqipnis qi kapëcen rrethin e ngushtë të bajrakut; kuptimi i

njij drejtësi shoqnore gjithënji nëmën të Shqipnis qi shutitë mëninat, zgjanon shpirtnat, zbutë gjakun: dëshiri i një përparimi qi tue lanë të paprekun themelet shpirtnore të kombit – nder, besë, burrni – zhdrivillon gjendjen e mjerueme t’ande tue e naltësue në një shkallë ma të denjë për shekullin XX.

Por kemi ardhun edhe me nuanë dishka prej teje, me marrë një mësim për vete e vllazën qi na presin në qytet.

Do të zbresim këtej me lajmin se Shqipnija e vërtetë asht midis maleve t’atdheut, këtu midis jush sikurse midis të gjithë Malsorve të tjerë arbnorë.

Shqiptari qi don të shërohet nga smundjet shpirtnore qi e shqetësojnë, të vijë e të prehet në heshtjet e freskëta të këtyne maleve ku tingëllojnë zanet misterioze të gjakut t’onë.

Poeti qi don të vejë në kangë thjesht shqipe ndiesit e veta ma të holla të vijë e të pijë ndër këto kroje të kullueta për në dashtë të këndojë me buzë të pastra.

Mbi këto naltësina zemra lirohet nga smira ndrydhëse, nga robnija e vogëlsive të jetës së përditshme, nga ligështit qi shkaktun lakmija e teprueme e të mirave landore.

Mbi këto naltësina çdo ide e bukur marrun jashta atdheut merr vulën shqiptare, këtu pranë këtyne burimeve, mund t’andërrohet madhënia e moçme ilire e përtrimet në ditë të soçme.

Kët lajm ju na e epni me vete. Kët lajm do t’ia sjellim vllazëve t’onë në qytet.

Përgatiti
LULASH BRIGJA,
prill 2024

◀ sociale për të ndihmuar në parandalimin dhe “zgjidhjen ndryshe” të kontradiktave dhe konflikteve sociale brenda dhe jashtë familjes, duhet të fillojmë që me objektivitet të bëjmë analiza pa sentimentalizëm dhe gjërave t’u vëmë emrat e duhur. Sepse kjo ngjarje, aq shumë tragjike, në thelbin e vet dhe tronditëse për familjet e viktimave dhe opinionin publik, u bë një lloj “casu belli” për trajtime kakofonike mediatike, me shumë deformime e ambiguitete interpretative. Shpeshherë media në vend të ruajë pavarësinë në analizën dhe gjykimin e rastit është bërë aleate me gjykime apo paragjykime të natyrës empirike apo shkaqeve të improvizuara. Duhet folur shqip, nëse duam të ndihmojmë për të parandaluar dhe shmangur ngjarje të tilla. Pavarësisht se viktimat nuk gjykohen, por përgjegjësia sociale na detyron të themi se sido që të kenë qenë rrethanat, motivet, presionet materiale e agresionet psikologjike që kanë ndikuar si faktor i brendshëm në këtë veprim, nëna ka kryer krim. Së pari, që ka bërë vetëvrasje, që është një akt i papranueshëm dhe i dënueshëm në çdo rrethanë, qoftë nga feja apo edhe shoqëria. Askush nuk ka të drejtë, në asnjë rrethanë t’i marrë jetën vetes me vetëvrasje. Kjo është e para. E dyta, nëse është e vërtetuar se ajo është vrasëja e fëmijëve të saj, ky është krim i rëndë dhe duhet cilësuar pa mëdyshje si i tillë. Megjithatë, tani, pasi ngjarja ka ndodhur, na takon të mendojmë se çfarë duhet të bëjmë për të parandaluar akte të tilla. Dy janë buriemet e krimit dhe vetëvrasjeve: shkaqet e brendshme me natyrë psikologjike, mentale e shpirtërore, të cilat janë delikate dhe shpesh e bëjnë të pamundur parashikimin e vetëvrasjes. Por familja, shkolla, komuniteti dhe sidomos rrjeti kapilar i institucioneve mjekësore ka mundësi të dallojë, të marrë masa, të ndihmojë dhe parandalojë ngjarje të tilla. Nuk duhet ndonjë mënçuri e madhe që të dallosh njeriun kur shfaq gjëndje ankthi, pasigurie, dëshpërimi, makthi, paqëndrueshmërie emocionale, etj., që janë shënja të sigurta të fillimit të procesit të destabilitetit mendor, që mund të çojnë njeriun drejt suicidit apo krimit. Ndërhyrja në këtë rast mund të jetë shpëtimtare, rikuperuese dhe rehabilituese, duke shmangur tragjedinë e menduar apo të planifikuar të vetëvrasjes apo krimit. E dyta, janë rrethanat sociale, apo faktori i jashtëm që ndikojnë në situatë të tilla, që lidhen me statusin e familjes, gjendjen ekonomike, marrëdhëniet bashkëshortore apo lidhjet midis pjesëtarëve të familjes, konfliktet e mundshme, situatat e agravuara nga përdorimi i lëndëve psikotrope, drogë apo alkool, etj. Këtu është roli i institucioneve sociale dhe atyre të përkujdesit shëndetësor. Sidomos të nevojës për të patur ekipe mobile për të ndërhyrë në momentin e duhur dhe për të intervenuar me instrumente profesionale adekuate për ndryshimin e situatës materiale, psikologjike e sociale në familje.

- A ndikojnë negativisht përplasjet e politikës, që dhuna të bëhet prezente në çdo celulë të shoqërisë dhe si mund të ndikohet mbi një fenomen të tillë?

- Besimi se sa më shumë të përparonte demokracia në Shqipëri, aq më i zhvilluar, qytetar dhe qytetëruës do të ishte gjuha dhe dialogu politik, nuk po vërtetohet.

Përkundrazi gjëndja linguistike, retorike e oratorike e saj, në gjuhën e politikanëve të pozitës dhe opozitës, është duke u degraduar deri në nivele alarmante. Sidomos në këto ditë të nxehta klimatike dhe politike, marrëdhëniet e pozitës me opozitën kanë qenë të jenë të vështira. Nuk bëhet fjalë për mungesën e logjikës së kompromisit, që në politologji konsiderohet si “lavdia e demokracisë”, por thjeshtë për deformimin e standardeve dhe rrugullat e “gjuhës politike” në Shqipëri. Në Parlament dhe sidomos mediatikisht, ajo është banalizuar deri në limitet e fundit të etikës dhe ka marrë një rrugë të mbrap-



Sociologu Gëzim Tushi

shtë në dialogun interaktiv të politikanëve kundërshtarë. Madje ajo është deformuar keq jo vetëm tek politikanët profesionistë, ndikimi i saj si refleksi ngjitet ka filluar të ndihet në media dhe e reflektuar gjerësisht edhe në gjuhën komunikuese dhe dialogun neurotik tek publiku i gjerë. Nuk është fjala për të bërë teori për rolin e gjuhës në politikën moderne, por ama kur shikon këtë situatë të shpërdorimit ekstrem, nuk mund të mos evidentosh të vërtetën për nivelin e mjeruar të “gjuhës politike”, për këtë mjet kryesor, në mos të vetëm, me të cilin bëhet politika e kohës demokratike. Një mjet që është pasqyrim i faktit, që politika në këtë vend, në vend të emanciohej si instrument i komunikimit politik, kulturor e publik, po ecën drejt degradimit dhe banalizimit të saj. Nuk e di nëse politikanët tanë kanë nivelin e duhur dhe konceptin adekuat për të kuptuar se forca dhe vlera e gjuhës politike, si mjet komunikimi në shoqërinë demokratike, është shumë e madhe. Duket që politikanët, shumica e tyre më saktë, nuk e kanë të qartë “përgjegjësinë e gjuhës politike”. Këtë të vërtetë e kupton kur përballësh me atë që po ndodh në politikën shqiptare, në të cilën ka shpërthyer “epidemia” e një fushatë gjuhësore politike banale, e shfrenuar, e dalë nga kontrolli etik, nga vetëpërmbytja demokratike. Përgjithësisht politika jonë, tradicionalisht në tre dekada, ka qenë e ashpër, jo tolerante nga pikëpamja fizike, konceptuale e gjuhësore. Sipas mendimit tim, artikulli i gjuhësor ka rënë kaq poshtë, gjuha e politikanëve të këtij vendi duket se ka perceptuar në “fundin e lejueshëm saj”, duke e reduktuar debatin jo me instrumentet adekuate e elokuente të saj, por në gjuhë të ashpër, të drunjtë, të fortë, jo etike. Padyshim, atmosfera politike në Shqipëri duket se është e tensionuar për shkaqe thelbësisht ekstragjuhësore. Kjo ndihet dhe kuptohet lehtë nga qytetari, sepse është ai që po

përballet përditë nga “bombardimi politik” me gjuhën e “drunjtë”, madje të hekurit, që ka mbuluar politikën tonë. “Eteri” i jetës publike është inonduar nga fushata dhe kundërfushata retorike paralele, të goditjeve dhe kundërgoditjeve gjuhësore politike të pozitës dhe opozitës. Vrazhdësi e skajshme, brutaliteti i dukshëm, gjuhë politike devijante, e cila para se të shfaqet në ekran, gati ka nevojë për “pullë të kuqe”. Fytyra të acaruar, grimasa të pakontrolluara të politikanëve e kanë inonduar keq situatën qytetare. Kjo gjëndje e sjelljes dhe e gjuhës politike është duke e cënuar keq dinjitetin e politikës shqiptare,

e cila për fat të keq, jo vetëm që nuk po frenohet, por ka marrë rrugën e degradimit moral dhe profesional kreshendo. Një bezdi e vërtetë qytetare, që na vjen si “peshqesh” nga politika, të cilës të paktën mungesën e etikës së sjelljes politike dhe artikullimin banal gjuhësor, nuk ja kemi borxh. Sepse një politikë me gjuhë frenetike, të pa ekuilibruar, nuk dëmton vetëm cilësinë dhe performancën e politikës, por pengon qytetarët të jenë në gjëndje të dallojnë, ca më shumë, të ndajnë thelbin e vërtetë të debatit politik, esencën e çështjes nga objekti i artikuluar i “gjuhës politike” që përdoret. Kaq intensive është bërë të folurit me tone banale dhe ofenduese, sa që është bërë e vështirë për qytetarin të dallojë se ku është “argumenti” dhe ku fillon “shpifja”, ku është dhe sa është e vërteta e konfliktit pozitë-opozitë dhe ku mbaron retorika gjuhësore si mjet që fsheh objektin e vërtetë të konfliktit politik, pas “ambalazheve” gjuhësore të përdorura nga politikanët. Gjuha e politikanëve ka humbur sensin, elegancën, argumentin dhe është lëshuar brutalisht në “fushën e vet”. Madje, tani lëviz e lirë, pa asnjë “censurë etike”, sepse ka dalë e lirë në qejfin e saj. Në vend të gjuhës që duhet të ketë argument politik mbushamendës, ne po përballemi me një “fjalamani” të tepërt, me abuzime të shëmtuara me faktet dhe të vërtetat, me shkelje të rregullave dhe standardeve të komunikimit politik. Në historinë e politikës moderne, jo vetëm në Shqipëri, ka raste kur objekti delikat i një debati mund të çojë në degjenerime të përkohshme të gjuhës politike. Por kjo që po ndodh në politikën tonë është ndryshe. Nganjëherë të duket më shumë si qëllim në vetvete, nga që nuk ka aq “lëndë ontologjike”, që të justifikojë këtë gjuhë me logjikë politike sakate, të artikuluar keq, e cila jo vetëm po rëndon situatën e vet, por veçanërisht gjëndjen psikologjike të qytetarit. Nuk është gjuhë

politike ajo që kanë përdorur politikanët kundër njëri-tjetrit, sepse në esencë nuk kemi gjuhë që pasqyron të vërtetën politike, por një gjuhë që ka marrë formë të shëmtuara, dredharake, që nuk të tregon as thelbin e debatit, sepse është një gjuhë që nuk është e lidhur drejtpërdrejtë me përmbajtjen e debatit dhe objektin e të menduarit, madje as me standardet elementare, mbi të cilat duhet bazuar të folurit politik. Kjo e ka cënuar rëndë nevojën dhe detyrimin gjuhësor elitist të politikanëve. Në politikën e sotme moderne ka një normë edukate gjuhësore, që politikës i vjen si imperativ kategorik i brendshëm, të paktën që nga koha e Aristotelit, sipas të cilit punët e shtetit dhe të politikës duhet të udhëhiqen nga ata që kanë edukim dhe formim sa politik, etik edhe gjuhësor. Politika është art i vështirë, sidomos kur duhet lufta për gjetjen e argumentit dhe përdorimin adekuat të gjuhës, sepse plotësimi i këtyre standardeve kërkon formim intelektual. Politikanët tanë kanë filluar të flasin pa doganë, pa kujdes etik. Si qytetar i këtij vendi, mendoj se duhet frenuar kjo gjuhë banale, që nuk është natyrale apo organike, për të zhvilluar politikën në një vend të qytetëruar. Nuk është modeli gjuhësor i duhur që duhet përdorur, sidomos nga ata që udhëheqin punët e politikës në këtë vend. Por askush nuk beson se e keja është vetëm këtu dhe problemet e ditës për politikën tonë janë vetëm “probleme gjuhësore”. Çështja është ca më e thellë. Por atmosfera gjuhësore që ka krijuar politika shqiptare, duke u marrë në frontin më të gjërë të mundshëm me banalitetet, po ndikon shumë në deformimin e opinionit demokratik të qytetarëve, të cilët janë bombarduar me gjuhë politike banale, e fshehur në emër të moralitetit politik.

- Sapo ndodh një krim, çdo shqiptar bëhet gjykatës dhe vë dorë “me kompetencë” mbi fajtorin. Si e shpjegoni këtë gjë?

- Është e vërtetë që shoqëria shqiptare, për shkak të së kaluarës së vet kolektiviste, vazhdon incernë e gjykimeve populiste dhe reagimeve instiktive, bazuar në arketipet e gjykimeve dhe paragjykimeve të ardhura si module të gatshme të reagimit. Shpesh të parakohshëm apo instiktiv. Kjo është një nga shënjat e nevojës së formimit dhe konsolidimit modern të shoqërisë shqiptare, për të mbajtur distancën nga gjykimet e improvizuara apo konkluzionet e parakohshme. Shqiptarët e kanë qejf gjykimin e personalizuar dhe konkluzionet e “instancës së fundit” për çdo ngjarje apo raste. Këtu kanë ndikimin e tyre kontroversal edhe sistemet e informimit dhe gjykimin, të cilat gjithashtu nuk kanë reagime adekuate dhe informacione definitive e të bazuara në fakte. Kjo bën pastaj që të kemi “çarje të brendshme” të opinionit publik, gjykime të diversifikuara, të cilat, në jo pak raste, shoqërohen me konflikte të përhapura, të cilat përplasen në të njëjtën kohë me paradigmat morale dhe gjykimet e secilit, të lidhura këto pastaj me nivelin e tyre kulturor, traditën e kulturën familjare, paradigmat rrethore jetike dhe stuatat e habitateve komunitare. E kemi patur, për fat të keq, në AND e shoqërisë tonë procedimin dhe gjykimin e ngjarjeve, fakteve, ndodhive duke i vënë nën “panoptikonin” ▶

Në vend të eulogjisë funerale për intelektualin, mësuesin, drejtorin, pushtetarin dhe njeriun e mirë, Gjelosh Lulash Ndreshaj

Pa dëshirë, për moshën, por me obligim si bashkëfshatar, po shkruaj disa rreshta për jetën politike, shoqërore, intelektuale e familjare të ndjerit Gjelosh Ndreshaj.

Gjelosh Ndreshaj lindi në vitin 1957, në Dakaj të Nenmavriqit, vllaznia Pecmikaj, në një familje shaljane të trungut të Marash Palit. Gjyshi, Gjelosh Mhill Nrethi ishte nipi i Prek Nout të fshatit Ndreaj të krahinës së Shoshit i tretun në Arabi, me shumë shoshjane të tjerë dhe nuk u kthye ma.

Prek Ndou e Marash Kola / Po I bien detit dora-dora

Axha i Gjeshit, Dode Mhilli ishte rreshtua e përkrah Ndoke Gjeshit me kohe dhe si pothuajse e gjithë elita politike e kohës ishin skeptikë për idetë komuniste, që po përparonin me shpejtësi në Ballkan, u vra dhe nuk ka një vrap si shumë të tjerë të zhdukur në Shqipëri.

Prindërit e Gjeshit, Lulash Mhilli e Kastrine Lulja u martuan në vitin 1943 dhe mbas 15 vjetëve martesë u fali Zoti Prenden, fëmijën e pare. Gjeshi ishte djali i madh dhe gëzim i madh i familjes dhe shpji mbushet plot me fëmija të tjerë, me Deden, Noshin, Shuken e Gjyten.

Gjeshi ishte një nxënës shumë i mirë,

mbaroi shkollën fillore në fshat, Nenmavriq dhe shkollën 8-vjeçare në fshatin Gimaj, në vitin 1972 dhe kur horizonti i dijes po hapej, lufta e klasave fillon gjuetinë në familjen Ndreshaj. Mbas shumë përpjekjeve, me ndërhyrjen e miqve e kumarve, Gjeshit i jepet e drejta e studimit në gjimnazin "Sherif Hoxha", në Kopluk, dhe e mbaron me rezultate shumë të mira, në vitin 1976.

Kërkesa e tij, për shkollën e lartë nuk u miratua, për arsye biografjet, por me ndihmën e drejtorit të shkollës në fshatin Toplane, Prele Shtyani, fillon punë në detyrën e mësuesit, për lenden e kimisë dhe vijon deri në vitin 1977.

Gjate punës e mesësit u njoh me shoqen e jetës, Dranen dhe formuan familjen e patën katër fëmijë të mrekullueshëm. Etja për dije e shtynë Gjeshin të vinte në lëvizje miq e dashamirë në fshat e në Shkodër, në mes tyre familjen Dergjini derisa arriti të regjistrohej në Institutin e Lartë Pedagogjik "Luigj Gurakuqi", në Shkodër, dega bio-kimi, me shkëputje nga



puna, dhe u diplomua.

Në vitin 1982 emërohet mësues në degën Bio-kimi, në shkollën e mesme të përgjithshme "Mehmet Shpendi", në Breglumi, ku punoi për vite me radhe.

I përkrahi, i mbështeti dhe u përfshi në ndryshimet politike të viteve 90, anëtar e drejtues i Partisë Demokratike, u zgjodh kryetar i pare pluralist në fshatin Nenmavriq, zgjidhet anëtar i këshillit të komunës Shale në tre legjislatura. Në te dy të parat, Gjeshi mbuloi në këshill të komunës problemet e arsimit dhe në legjislaturën e trete u zgjodh Kryetar i këshillit të komunës Shalë.

Ju besuan detyra drejtuese në arsim, drejtor shkollë në fshatin Gimaj, drejtor shkollë në gjimnazin "Mehmet Shpendi", drejtor shkollë në fshatin Domen dhe në fund drejtor i konviktit të shkollës së mesme industriale "Arben Broci"

Me diferencë moshet, por pata fatin të punojmë bashkë prej vitit 1990-1998, Gjeshi ishte njeri i qete, i matun, por shumë i thelle

në argumente, nuk tërhiqej prej ideve dhe i mbronte ato me shumë vendosmëri, ishte i respektueshëm me të gjithë moshat, i dash-tun me njerëzit, i lezetshëm dhe me humor shumë të holle, ishte shumë modest.

Në botën e "ujqërve", modestia rrinë gjithmonë në stol të rezervave, kurrë nuk e rrahi gjoksin me mburrje, punoi shumë, por u vlerësua pak, mori vetëm një certifikatë modeste "100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin", mbas afro 40 viteve pune në arsim dhe ketë nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini". Mësuesi është mision, nuk është vetëm punë që paguhet.

Gjeshi shkoi në amshim i rrethuar nga familja e tij e dashur, u varros me ceremoni sipas traditave të zonës, pa fjalime butaforike, me respektin e familjes së tij, të vllaznisë, fshati që u lindi e u rrit, të zonës që i shërbeu, kolegeve, nxënësve të tij të shumtë, shokëve e miqve, që punoi me ta.

Të koftë dheu i lehtë Gjeshi!

Shpirti jot pushoftë në paqe!

Gjeshi do të kujtojmë gjithmonë me respekt e mirënjohje!

DEDË PRENDAJ, Nju-Jork
7 maj 2024

◀ e njohur të "vijës së masave" dhe të drejtës së kujdo për të "gjykuar për gjithçka e për çdo gjë". Besoj se koha e sotme ka si gurë caku të drejtat e njeriut dhe gjykimin e fajtorit nuk e bëjnë as masat, as opinion publik, por organet e drejtësisë. A, kur është fjala për gjykim moral të një akti që ka peshë, interferim dhe ndikim social, po, kushdo ka të drejtë të gjykojë e të mbajë qëndrim. Qoftë në nivel social apo në plan të personalizuar.

- Përfundimisht, a shihni ju mundësi dhe rrugë për t'i shëruar këto plagë sociale në Shqipëri?

- Situata sociale në Shqipëri këto kohët e fundit është bërë shumë e agravuar. Në sipërfaqe të saj kanë dalë shumë probleme. Të reja dhe të vjetra, të njohura e të panjohura, të cilat duket sikur e kanë zënë shoqërinë në befasi sociale dhe e kanë "kapur për fyti" dhe nuk po e lënë të marrë frymë. Shoqëria po shfaq doza të larta neurotizmi dhe konfliktualiteti shoqëruar me zgjerim të dhunës dhe shtimit të marrëveshjeve sociale. Probleme të shumta në familje, e cila në disa raste duket se ka pësuar rapturë të forta në strukturë, funksionalitet e komunikimet interpersonal brenda saj. Në vend që të jetë një qendër e paqes sociale për pjesëtarët e saj, ajo po bëhet një vatër e konfliktualitetit midis bashkëshortëve, prindërve dhe fëmijëve, të rinjve dhe të moshuarve. Probleme ka edhe shkolla, e cila gjithashtu po vuan patologjitë e saj jo vetëm në aspektin profesional e cilësor të mësimdhënies e mësimnxënies, por sidomos në "thelbin deontologjik" të përgjegjësive të saj formuese dhe edukative për formimin qytetar të nxënësve. Probleme kanë edhe institucionet sociale, shëndetësore, strukturat e shtetit dhe pushtetit vendor. Megjithatë, unë mendoj se ka një rrugë për të ndalur këtë kaos social dhe anarki të jetës urbane. Sipas mendimit tim, është e udhës të investojmë për të forcuar ato që përbëjnë bazën e formimit dhe rregullimit të "amortizatorëve" të shoqërisë. Kjo do të thotë që politika, shteti, bashkë me ata që

shoqëria i ka zgjedhur apo të përzgjedhur në strukturat e politikëbërjes apo në "bordin e shoqërisë", duhet të mendojnë dhe të investojnë për të rregulluar funksionimin normal të institucioneve të autoritetit social. Kjo do të thotë që për të sjellë në normalitet jetën shoqërore, duhet të forcojmë ato institucione ku mësohet, edukohet, formohet, por dhe ndëshkohet, sikurse janë familja, shkolla, institucionet fetare, media, shoqëria civile, por dhe institucionet e autoritetit shtetëror.

- **Është degjeneruar familja shqiptare aq shumë, sa tradhëtia bashkëshortore është bërë shqetësim i ditës. Në gjykimin tuaj, si e shikoni këtë fenomen tronditës?**

- Padyshim, një nga dukuritë që po e trondit familjen shqiptare dhe po i shton problemet dhe kostot sociale shoqërisë, është zgjerimi i përmasave të divorcit. Në shikimin tim, divorci duhet parë me kujdes në të dy "kahjet" e veta. Nga njëra anë, ai është "kazma e martesës", por nga ana tjetër, është edhe shprehje e emancipimit të saj, si zgjidhje e qytetëruar në raset kur lidhja martesore nuk funksionon. Megjithatë, fakti që sasia e divorceve është rritur në përmasa alarmante dhe me shifra sociale tronditëse, të detyron të mendosh se shkaqet e këtij fenomeni janë të lidhura me martesën, me kulturën e martesës. Sepse shumë martesë bëhen shpeshherë me mëndjelehtësi dhe pa përgjegjësi, në mënyrë të parakohshme ose nën tundimet e seksualitetit. Krahas tyre, dhe shumë evidente, është tronditja e monogamisë martesore (martesa seksualisht e mbyllur) dhe përhapja e lidhjeve jashtëmartesore apo e lidhjeve paralele. Pasojat e numurit të divorceve në shoqërinë shqiptare janë të shumta, të shumëfishta e të shumëllojshme. Ato rëndojnë mbi familjen, gratë, fëmijët dhe të moshuarit. Megjithatë kemi nevojë të përmirësojmë edukatën për martesën, kulturën e saj dhe kulturën e divorcit, në mënyrë që ato së pari, të jenë zgjidhje humane, të qytetëruara e konsen-

suale për ato martesë që nuk funksionojnë apo që janë në situata të parikuperueshme konsensualiteti. Ndërkaq është e udhës që partnerët e divorcuar, por që kanë fëmijë nga martesë e tyre, duhet të kuptojnë dhe të pranojnë se ata, nga divorci, nuk janë më bashkëshortë, por statusi i prindit dhe përgjegjësia sociale e prindërimit ndaj fëmijëve që kanë sjellë nga martesë, mbetet një detyrim i pandryshuar. Ky është një problem që po e shqetëson situatën e fëmijëve, të cilët nga divorci nuk duhet të mbeten "jetimë sociale", kur i kanë prindërit biologjikë. Qoftë edhe të divorcuar...

- **Sa e rëndësishme është marrja serioze e shëndetit mendor dhe sa e vlerësojnë sot institucionet shtetërore dhe sociale?**

- Filozofët, psikologët, sociologët dhe psikoterapistët kanë parashkuar se për shkak të ndryshimeve thelbësore që po ndodhin në jetën e sotme, ekzistenca e një shoqërie me natyrë liberale dhe individualiste e gjithnjë e më pak solidare e humaniste, thellimi i natyrës egoiste dhe ambicioze të njeriut, etja e shfrenuar për para, sukses, karrierë, celebritet e famë kanë krijuar kushtet e shfaqjes së problemeve dhe shqetësimeve të shëndetit mendor. Kudo në shkollë dhe në vendet e punës, në rrugë e jetën komunitare përballemi me njerëz që shfaqin shënja pasigurie e dëshpërimi, ankthe e makthe, tronditje shpirtërore dhe çrregullime psikologjike. Është një situatë që duhet vlerësuar, duke evidentuar shkaqet e kësaj dukurie sociale e psiko-patologjike si dhe masat që duhen marrë për të parandaluar agravimin e sëmundjeve dhe kalimin e tyre nga niveli i shqetësimit psikologjik, në standardin e vështirë të sëmundjeve psikiatrike. Duhet treguar kujdes me fëmijët, por dhe njerëzit e tjerë, kur ata shfaqin shënja sikurse janë vetmia, mbyllja në vetvete, asocialiteti, mungesa e dëshirës për t'u përfshirë në jetën sociale, ndërprerja e lidhjeve komunitare, mungesa e dëshirës për të

shkuar në shkollë apo për t'u përfshirë në punë aktive, mungesa e oreksit e plot shenja somatike paralajmëruese. Në këtë rast, në mënyrë evidente, është e nevojshme që prindërit, mësuesit, familjarët duhet të kenë kulturën dhe vigjilencën e duhur për të dalluar në horizont fillimet e shfaqjes së problemeve psikologjike, duke bërë ndërhyrjen e domosdoshme përmes trajtimit familjar dhe sidomos psikologjik të shenjave të para të anomalive shpirtërore apo psikologjike. Parandalimi i sëmundjeve mendore është plotësisht i mundur dhe shërimi plotësisht i sigurt, nëse i diktojmë simptomat tek njerëzit dhe bëjmë intervenimet e duhura psikosociale për të rikuperuar shëndetin e tyre mendor. Tani i kemi njohuritë, kushtet, institucionet dhe një armatë të gjerë me punonjës të specializuar, sikurse janë psikologët gjeneralistë e të specializuar, punonjësit socialë, psikoterapistët, sociologët, që kanë "pushtetin e dijes" dhe kompetencën profesionale. Na duhet një kulturë tjetër, duke shmangur stigmën që akoma në pjesë të caktuara të shoqërisë ekziston, që shfaqet në frikën nga kontakti me figura të tilla profesionale, sikurse janë psikologët, sociologët apo edhe psikiatrit. Tendencën globalisht në zgjerim e problemeve të shëndetit mendor, që po agravohen në këtë shoqëri turbokapitaliste e likuide (sikurse thotë Zygmunt Bauman), të konkurrencës dhe rivalitetit të pandërprerë, me punë stresuese dhe me orë të gjata, kërkon një tjetër kulturë dhe trajtim preventiv, paraprakisht diagnostikues dhe pastaj edhe terapeutik e rikupeues nga familja, shkolla dhe institucionet e specializuara të shëndetit mendor. Një rishikim më me përgjegjësi i Strategjisë së Shëndetit Mendor dhe aktivizimi më kompakt i strukturave dhe institucioneve me funksione specifike të drejtpërdrejta apo të tërthorta, është një detyrë imediate dhe konditë "sine qua non", për t'u përballur me situatën aktuale, por dhe tendencat e së ardhmes në këtë fushë delikate të jetës sonë sociale.

Gjenerali Tahir Sinani ngeli në zemrat dhe mendjen e Shqiptareve, heroit i Shqipërisë, Kosovës, Preshevës dhe Maqedonisë së Veriut

JETA E TAHIRIT!

Tahir Sinani lindi me 25 Maj 1964 në fshatin piktoreske Gri e Njësisë Administrative Bujan, Bashkisë së Tropojës dhe ra dëshmorë me 29 Korrik 2001 në vendin e quajtur "Zabel i Kukulit" afër qytetit të Gostivarit të Maqedonisë së Veriut.

Tahir arsimin e detyrueshëm e kreu në vend- lindje dhe të mesëm për agronomi, në qytetin Bajram Curri. Pas mbarimit të shkollës së mesme përfundojë në Zall-Herr të Tiranës, në shkollën ushtarake në degën e armës së kimisë e Biologjike me rezultate te larta, duke u bere mjeshtër i përsosur i përdorimit të të gjitha llojeve të armeve. Kështu, në moshën 22 vjeçare emërohet instruktor i stërvitjes së Divizionit të Këmbëorisë, në Bajram -Curr.

Gjate luftës në Kosovë, Tahir emërohet instruktor në Kampin e Stërvitjes, në Tropoje, me kontingjentin e luftëtarëve që përgatiteshin për luftë në Kosovë. Ai, la gruan, Shpresën, djalin Rezartin dhe vajzat Rezarten e Rugovën e u nisen për në Kosovë, kështu në Korrik 1998, me shokët që i kishte stërvitur në Divjakë të Kosovës dhe më pas në qafen e Pagarushes, ku u zhvilluan 2 orë luftime. Në këtë beteje u asgjësuan me sukses paramilitare serbe, të cilët popullatën për rreth i kishin terrorizuar. Me këto raste Tahir, i cili u dallua për heroizëm të papare, emërohet instruktor i stërvitjes dhe komandante i

Njësisë Speciale "Arbëria". Më vonë dallohet Tahir në luftime për hapjen e korridorit të Koshares dhe për këto suksese, Tahir emërohet Komandant i Brigadës së Zonës Operative të Pashtrikut.

Me 12 Qershor 1999, Tahir me Brigadën e tij hyjnë në qytetin e Prizrenit. Tashme të gjithë thirrnin "O ku je o Tahir Kosova!" – Tahir pasi përshëndetet me koleget dhe duke marrë bekimin e vëllezërve Sahitin, Njazin, Canin, Rizan, Agimin, Skënderin, Besnikun dhe motrës Ferides, nisjet për në Luginën e Preshevës-Serbi. Tahir u dallua në luftimet e Dobrasit, Kanculit e Bujanovcit dhe të gjithë filluan të thirrnin – "O ku je o Tahir Presheva!"

Më vonë, Tahir arriti në Tamushe të Gostivarit, në Maqedoninë e Veriut. – Tahir Sinani është komandant i Brigatës 116 "Xheme Gostivari" – Të gjithë tashme e thirren "O ku je o Tahir Tetova!" E bashke me shokët Brahim Ademi (TT), Naser Ademi, Hisa Faslin dhe Hyse Emini – Mira ranë dëshmorë duke skuqur me gjakun e tyre zonën e Gostivarit, me 29 Korrik 2001.

Gjeneral Major Rexhep Selimi shkruan asokohe:

Rruga jonë ka nis me shekuj
Shokë ju mos u ndalni
Nëse doni t' me kujtoni
Amanetin mbani

Unë jam veç një çlirimtarë
Kështu me deshi liria
M' kanë pas thënë Tahir Sinani
Jam Tahir Shqipnija.
Në të vërtetë Tahir u lakua!
Tahir Tropoja!
Tahir Kosova!
Tahir Presheva!
Tahir Tetova!
Tahir Shqipnija!

Trupi i tij prehet në varrezat e Dëshmorëve në Landovice- Prizren.

5 MAJ 2024

Mëngjesi i 5 Majit 2024 i gjeti veteranet dhe pasardhësit e tyre të varrezat e dëshmoreve në Bajram – Curr. Pas himnit kombëtar për këtë përkujtimore madhështore, foli zëvendës kryetari i veteraneve të Tropojës, Gëzim Prengzi. Morën pjesë Kryetari i veteraneve Tropojës, Zeqir Hasanpapa; kryetari i Partisë socialiste Tropojës, Egzon Shkurti; nënkryetaret e Bashkisë Tropoje, Kujtim Rexha dhe Abedin Kerrnaja dhe Nen prefekti i Qarkut Kukësit, Altin Bebat. Në fund u bene homazhe dhe vendosen buqeta me lule pranë varrezave të Dëshmorëve.

..... 5 Maji 2024, në orën 12.00 u zhvillua ceremonia për të përkujtuar jetën dhe veprën e Heroit Legjendar Tahir Sinani, në Qytetin Bajram -Curri.

Ceremoninë e hapi Kryetari I Bashkisë Bajram Currit, Rexh Byberi.

Ishte Kryeministri i Kosovës, tani deputet, Ramush Hajredini foli për bashkëpunimin dhe heroizmin e pashoq të Tahir Sinanit. Gjithashtu ai, i dorëzoi djalit Tahir Sinanit, Rozartit një dekoratë për Heroizmin e Tahirit.

Deputeti i Parlamentit të Maqedonisë Veriut dhe Kryetar i PDI –së, Ali Ahmeti foli për luftërat dhe heroizmin e Tahir Sinanit në Maqedoninë e Veriut.

Ish Kryeministri I Shqipërisë, tani deputet Pandeli Majko, solli kujtimet për përgatitjen e lart si ushtarak të Tahir Sinanit.

Fjala ish Kryetarit të Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, tani Kryeministër i Qeverisë, Telat Xhaferi u mirëprit me duartrokitje dhe brohoritje nga të pranishmit.

Në emër të familjes të Tahir Sinanit, përshëndeti të pranishmit, vajza e tij, Rugova.

Përveç malësorëve të Malësisë të Gjakovës, morën pjesë me dhjetëra ish Oficerë, Gjenerata dhe pjesëtar të UÇK-së nga Kosova, Metvegja, Maqedonia e Veriut dhe Diaspora.

Punimet i ndoqën edhe deputetët nga Kosova, Fatmir Lima, Time Kadria dhe Hajdar Beqa si dhe Perfekti I Qarkut Kukësit, Agron Geca.

Gjithashtu ish deputeti i Kuvendit të Shqipërisë, tani Kryetar Unionit Artistik të Kombit Shqiptar, Azgan Haklaj, mori mirënjohje për këtë organizim.

Këngët e vallet vazhduan pa kufi. Koçidencë ishte se, në qytetin e Bajram Currit, ishte organizuar me 4, 5 e 6 maj 2024 "Terveza Dardane", me pjesëmarrës nga gjitha trevat Shqiptare dhe Diaspora, e cila i dha një larmi të paparë ndonjëherë.

Në fund u bë shpalesja e monumentit të heroit Tahir Sinani, në Bronz i ndërtuar nga skulptori i mirënjohur nga Kosova, Ylber Krasniqi.

Me dhjetëra buqeta dhe kurora me lule u vendosen tek monumenti i Heroit Tahir Sinani, që ra në sy një kurorë madhështore e vendosur nga Zenun Aliaj, në emër Komitetit të organizatës së Veteraneve të Tropojës.

Heroizmi i Gjeneral Tahir Sinanit do të ngelet gjithmonë në zemrat dhe mendjen e Shqiptarëve!

IBRAHIM HAJDARMATAJ,
Anëtar i Komitetit Kombëtar të organizatës së Veteraneve dhe pasardhës i LANÇ- "NDERI I KOMBIT"



Foto pjesmarrësit



Foto Rexh Byberi duke fol



Foto Ramush Hajredini duke pershendet



Foto Pandeli Majko fjalën e rastit



Foto Ali Ahmeti duke sjell kujtimet



Foto Telat Xhaferi duke i pershendet pjesmarresit



Foto Heroit Legjendar Ne Bronx

Valentin Livadhi - biznesmen dhe etnograf i suksesshëm

Mbas 90-tës, në vitet e demokracisë, shumë familje Dukagjinase lëvizën nga vendlindja për në zonat urbane apo rreth tyre për një jetë më të mire, sidomos për brezin e ri. Këto familje u integruan shumë shpejt në vendbanimet e reja, duke qenë shumë të suksesshme në të gjitha fushat e jetës. Një ndër këta dukagjinase është edhe Valentin Livadhi nga fshati Plan i krahinës së Pulit, për të cilin do të flasim më poshtë.

Valentini u lind në vitin 1973, me prind Fran Ded Prëla dhe Pashkë Zefja.

U lind në një familje emërmadhe, me tradita atdhetare, e cila është shquar për nder e burrëri me rrënjë të thella si çetina në shkëmb, e përmendur si shtëpia e Prëlë Kolës Planit (stërgjyshi i Valentinit), e cila ka përkrah në çdo kohë progresin, duke qenë shumë aktive.

Familja e tij, në çdo kohë ka marrë pjesë në ngjarjet kryesore të historisë, ka qenë shumë aktive dhe kontribuuese në qëndresën kundra ushtrive malazeze, madje pjesëtare të saj kanë dhënë edhe jetën, duke treguar heroizëm të pashoq, duke u rreshtuar përkrah 81 të rënëve në luftën e korrikut të vitit 1915. Martin Kola, me heroizmin e tij ka arritur deri në kufijtë e legjendës. Është edhe nipi i Gjergj Zefit nga Pepajt e Shoshit një ndër njerëzit më pozitiv e me vlera në Shosh e më gjerë. Edhe Valentini është duke ecur në gjurmët e të parëve duke e ngrit më lart emrin e tyre. Valentini do ta shohim në dy këndvështrime: në profesionin e biznesmenit dhe etnografit i suksesshëm të harmonizuar me njëra tjetrën. Me largimin nga vendlindja i vuri vetes detyrë, që të krijojë pavarësinë ekonomike, duke jetuar me punë të ndershme dhe vetëm me djersën e ballit. Punën e ka në gen të trashëguar nga të parët e tij. Vendosi të merrej me trageti, duke marrë një lokal me qera dhe hapi një bar – restorant, të cilin e ka edhe sot. Nisur nga natyra e tij e qetë dhe bashkëpunuese, çdo ditë i shtohet klientela me njerëz kryesisht malësor, të cilëve u krijonte mundësi, që

pijet e ndryshme kush të donte mund t'i shoqërojnë edhe me ndonjë gjë me gatime të traditës. Është i vetmi në llojin e tij, që ju ofron klientëve diçka falas, që jua imponon të konsumojnë ndonjë pije më shumë. Sot ka një klientelë shumë të



kulturuar larg zhurmave dhe zënkave siç ndodh rëndomtë në ndonjë lokal tjetër. Vet jua ka imponuar një sjellje të tillë, duke insistuar në krye të herës që klient rrëmujaxhi nuk kenë vend në lokalin e tij. Klientela e tij tregon se, dukagjinasi kanë përparuar shumë në integrimin në jetën urbane, duke paraqitur në çdo hap shumë vlera qytetare. Edhe vete Valentini i ka harmonizuar shume mirë vlerat më të mira, të cilat i ka marre nga vendlindja me edukatën qytetare të fituar gjatë 26-viteve jete ne qytet. Shquhet për gjakftohtësi, aftësi të rralla komunikues, por edhe kritik kur është nevoja. Kjo ka bërë, që çdo dite ti shtohen frekuentuesit. Për vetë pozicionin që lokali i tij ka, gjithçka ju ofron klientëve është shumë cilësore, e freskët dhe gjithçka bio, duke ruajtur dhe traditën.

Ana tjetër, që na nxiti të shkruajmë

për këtë djalë shumë punëtor dhe i pasionuar është se, lokalin e tij e ka kthyer në një "muze" etnografik shumë të pasur, duke dhanë një kontribut shumë të çmuar në pasurimin e trashëgimisë kulturore të Dukagjinit. Ka shumë vlera, sidomos për të rinjtë, për të krijuar një ide se si kanë jetuar te parët tanë dhe cilat kanë qenë mjetet e jetës tyre. Në të gjitha faqet e lokalit nuk e ka një "pëllëmbë" vend të pa mbuluar nga mjete të vjetra, të cilat, Valentini i ka grumbulluar ndër vite, kryesisht të blera në fshatra të Dukagjinit. Është i veçantë në llojin e vet, që të tillë nuk ka në Qarkun e Shkodrës. Çfarë nuk ka aty: Ora të ndryshme, radio të gjitha llojeve të hershme dhe të vona, mjete të ndryshme për përpunimi e duhani, enë të ndryshme tamblit e uji, mjete druri për gatim buke, kandila të ndryshme për ndriçim me vajguri, ene gjithfarë kuzhine prej druri, alumini e qeramikë, enë pijesh druri, qelqi, kungulli e të tjera. Shumë gjera të vjetra karakteristike: pishtarë, vargojnë zjarri, kurthe të ndryshme, djepe, mjete kafeje: dollap e mullinj; karrige, stola prej druri e thupre, ene qeramikë, dheu për ujë e zierje. Enë të ndryshme për përpunimin e tamblit vetëm prej druri, kandar të

gjitha llojeve dhe kohërave të ndryshme, vegla muzikore të reja e të vjetra, zile e trokaç bagëtish, mjete të ndryshme pune druri dhe metalike, mjete të ndryshme gjuetie (jo arme); mjete për përpunimin e leshit e materiale për veshje të përdorura nga gratë. Nuk ka vend ku ti ekspozojnë, sepse ka edhe veshje karakteristike Dukagjinase, të cilat sot i përkasin arkivës. Ka edhe shumë materiale të tjera, që nuk po i përmendim për mungesë vendi, por edhe ndonjërin nuk dimë as ti emërtojmë.

Është një muze i vogël etnografik mjaft i pasur, të cilin Valentini edhe me mungesë vendi përpigjet për ti ekspozuar përditë, përpigjet t'i ekspozojë. Është shumë i nevojshëm, për tu pa nga të gjithë, në veçanti nga të rinjtë, sepse nuk mund ta imagjinojnë mënyrën e jetesës të parëve të tyre dhe çfarë kanë përdorur për të mbijetuar. Ka shumë rëndësi me e ditë nga

kanë ardhur. Në këto materiale të grumbulluara i kanë dhënë miliona nga dukagjinase brenda dhe jashtë vendit, oferta të cilat Valentini i ka refuzuar, sepse nga pasioni është familjarizuar me to. Është e domosdoshme, që pushteti vendor apo ndonjë biznesmen i fuqishëm me ja dhënë një ambient për ekspozimin e tyre, sepse të gjithë këto thesare i ka në një ambient me qera dhe të grumbulluara vetëm me forcat e veta.

Valentini është edhe prind e familjar shembullor. Bashke me Gjelinën, vajzën e Fran Kole Marashit nga fshati Gimaj të krahinës së Shalës, nga një familje me emër të mirë në Shalë e Dukagjin, e cila i përballoj me shumë sakrificë dallgët e jetës, lindën e rritën dy fëmijë të shkëlqyer-Blerinën e Bledarin, të cilët tani kanë filluar të dalin në pavarësinë e tyre. Ata, babën e tyre duhet ta kenë model, për dashurinë, për prindërit, sepse vetë Valentini, duke mbet jetim herët nga nëna, mbasi provoj emigracionin si shumë të rinjtë, u kthye dhe vendosi të jetojë pranë familjes si djali më i madh i Fran Dedes dhe kontribuoj në përbalimin jetesës dhe çuarjen më lart emrin e madh të familjes së tij.

Paraqitem shkurtimisht jetën dhe veprimtarinë e të riut nga fshati Plani - Valentin Livadhi, shumë i suksesshëm në biznesin e vogël të tij dhe në etnografi i talentuar, i cili jep një mësim për të rinjtë dukagjinase, sepse në përgjithësi nuk duan të dinë për të kaluarën, për vlerat kulturore të vendit nga kanë ardhur, për më shumë janë të dhënë pas celularit dhe një pjesë të madhe i ka kapluar parazitizmi. Valentini ka një opinion pozitiv dhe për të flasin më shumë superlativë. Ka dhe shumë vlera patriotike, që tregon dhe emërtimi që i ka vënë ambientit ku punon, Bar-Restorant "Livadhi", në mbiemrin e tij.

I urojmë që të eci në rrugën e nisur, të kenë suksese ende më të larta në vijim, duke u bërë shembull frymëzimi për bashkëmoshatarët e tij.

PRELË SHYTANI,
Shkodër, Maj 2024

*** KURIOZITETE *** *** KURIOZITETE *** KURIOZITETE *** KURIOZITETE ***

TRAJTIMI ME KOKAINË

100 vjet më parë, kjo substancë nuk konsiderohej e rrezikshme. Përkundrazi, mund të merrej në çdo farmaci. Kokaina u rekomandohej edhe fëmijëve si pilula gjumi. U përdor gjithashtu për të kuruar kollitjet dhe për të lehtësuar dhimbjen e dhëmbëve. Dhe si çdo ilaç tjetër, kishte shumë reklama të pikave dhe shurupit të kokainës.

DËRGIMI I FËMIJËVE ME POSTË

Tingëllon si një shaka, por në fillim të shekullit të XX, ishte absolutisht e ligjshme që të dërgoje një foshnjë me postë tek të

afërmit tuaj. Kostoja e transportit kush-tonte rreth 15 cent, me kusht që fëmija të peshonte jo më shumë se një dërgesë standarde. Ndoshta në këtë mënyrë, prindërit kursenin para kur dërgonin fëmijët tek gjyshërit e tyre.

KAFAZE NË DRITARE PËR FOSHNJAT

Në vitet 1930, në Britani, ju mund të shihni kafaze teli në dritaret e shumë shtëpive. Me këto objekte artificiale, foshnjat thithën ajrin e pastër, ndërsa nënat e tyre ishin të zëna me punët e shtëpisë. Është e pabesueshme, por këto kafaze janë

konsideruar të sigurta. Çfarë mendonin prindërit e asaj kohe?

HERMITËT E KOPSHTIT

Disa njerëz të pasur kanë bërë që njerëzit e tjerë të vuajnë vetëm për të përmbushur tekat e tyre të çmendura. Në shekullin e tetëmbëdhjetë, në Evropë, ekzistonte mënyra e të pasurit në kopsht të një "Garden hermit" personal. Ata e kishin të ndaluar të laheshin, të prisnin flokët, thonjtë dhe duhet të jetonin në një "shpellë" artificiale. E gjitha bëhej me qëllim që të tregonte "dekorimin e gjallë" për mysafirët e tij.

TRAJTIMI I DYSHIMTË

Në të kaluarën jo aq të largët, mjekët nuk kishin idenë për nevojën e dezinfektimit dhe përdorën të gjitha llojet e metodave të çuditshme: gjakderdhje për të gjitha sëmundjet, prerja e gjuhës për të "kruar" belbëzimin, lobotomi dhe goditjet elektrike. Edhe për mjekët më të suksesshëm në atë kohë, për shembull, si kirurgu ortopedik amerikan Lewis Sayre, operacionet me një rezultat vdekjeprurës nuk ishin një gjë e rrallë.

GJITHMONË NË SHËRBIM TË BASHKËSISË FRAN MIRASH PALI (VUKSANI)

Frani, lindi 29 tetor 1939, në fshatin Lotaj, të krahinës së Shalës, i biri i Mirashit e i Butes. Jeta për Franin ishte shumë e vështirë, u rrit me nenën Bute e gjyshin Pal Biba, por kurdoherë mbështetje ka pas Franin nga kushërinjtë e tij. Kole, Mark e Ndue Delia. Kujdesi i këtyre për rritjen, edukimin e shkollimin e tij ishte maksimal.

Shkollën fillore e përfundoi në fshatin e lindjes në Lotaj. Qysh në shkollë dallohej si nxënës inteligjent, pasi mbaroi shkollën me të gjitha notat 5 të konvertuara në 10-ta. Frani dita ditës rritej e bashkë me të edhe ambiciet për jetën. Gjithmonë, gjyshi Pali i ka folur për të atin Mirashin, i cili duke mos duruar pushtuesit e padrejtësitë, luftoi kundër tyre. Thënie për trimat e kësaj shtëpie, për vëllezërit e gjyshit Pali, të cilët asnjëherë nuk u pajtuan me pushtuesit dhe vdiqën burgjeve, brenda e jashtë vendit gjithmonë i jepnin force Franit. Vitet ecnin e Franit i vjen koha për t'u mobilizuar në shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Ushtrinë e përfundoi në Gjirokastër, u dallua për disiplinë dhe inteligjencë në përvetësimin e artit ushtarak. Frani gjatë shërbimit ushtarak fitoi respektin e shokëve dhe të eprorëve.

Frani u martue me Dilë Vaten nga fshati Lekaj, nga një familje e njohur jo vetëm në Lekaj, por në të gjithë krahinën e Shalës e më gjere. Frani e Dila linden dhe rriten gjashtë fëmijë. Pesë djem e një vajzë. U rritën dhe u edukuan, duke qenë



shembull në familje e shoqëri. Janë martuar dhe kanë krijuar familjet e tyre. Tre prej tyre jetojnë në Shkodër, me familjet e tyre. Ndërsa tre të tjerë jetojnë e punojnë në Itali. Për këto familje flitet fjalët më të mira, në bashkësinë ku jetojnë e punojnë.

Veprimtaria dhe pjesëmarrja e Franit në jetën shoqërore ishte e larmishme, duke u shërbyer kurdoherë bashkëfshatareve të tij me besnikëri dhe ndershmëri. Në ekonomi ai punoi në disa funksione, përgjegjës sektori, llogaritar e të tjera. Ai kurdoherë ka qenë i zgjedhur në organet e Partisë, në detyrën e sekretarit të organizatës bazë të Partisë e deri në byronë e Partisë së ko-

rregjistruan 6 aksidente me turistët e huaj, ku njëri prej tyre humbi jetën pas rrëshqitjes në një humnerë. Ky shqetësim u ngrit edhe në takimin që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Mirela Kumbaro, pati ditët e fundit me prefektët e vendit.

“Duhet ta parandalojmë lëvizjen e turistëve pa guidë, sidomos në zonat malore të Veriut. Kemi turistë të cilët lëvizin pa

operativës. Për shumë legjislatura është zgjedhur kryetar i këshillit të fshatit Lotaj. Detyra të cilat i kreu me ndershmëri e përkushtim në shërbim të këtij fshati të njohur të krahinës së Shalës. Për meritat e tij është shpërblyer me shumë stimuj moral, nga organet drejtuese të Partisë e të pushtetit të kohës. Në këto shina po ecin edhe pasardhësit e tij, djemtë e vajza, nipa e mbesa të Franit.

Deda tani është në pension, por gjithë jetën ka punuar me ndershmëri.

Pavlo ka shërbyer në forcat e rendit, duke u dalluar për guximin dhe profesionalizmin. Ka marrë pjesë në disa aksione të vështira të Policisë së Shtetit kundër krimit e korrupsionit, detyrë që vijon edhe tani po me të njëjtin prokupa-

cion, ndershmëri e guxim.

Çesku punon e jeton në Itali dhe bashkë me vëllezërit kanë hapur një biznes.

Një merak që Franin e ndoqi gjithë jetën e tij, ishte të dinte të vërtetën për babanë e tij, Mirash Palin, të cilin e kërkoi jo vetëm në Shqipëri, duke takuar njerëz të cilët kishin qenë në burg me të, por edhe në shumë shtete të Evropës. Dhe pas një pune të madhe, Frani me djemtë e tij, ja gjetën varrin në Gjermanin Perëndimorë. Aty ku ishin varrezat e të gjithë atyre që vdiqën në kampet e përqendrimit. Për meritat e larta Mirash Pali u shpall “Dëshmor i Atdheut”.

Pas viteve 1990, Frani aktivizohet në Shoqata të ndryshme: Anëtar i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe anëtar i Shoqatës mbarë-kombëtare të “Pajtimit të Gjaqeve” e të tjera. Kudo e kurdoherë

fjalët tij zunë vend duke kontribuar në pajtimin e disa gjaqeve, ndoshta nder më të vështirët. Madje shumë moshatar të tij e quanin një Anton Çetë të dytë.

Me ndarjen nga jeta të Franit, Lotajt humbën një prijës. Nuk ka pasur dasmë, apo vdekje ku të mos ketë drejtuar Franin. Pra, ka lënë shteg të madh, siç u shprehën shumë burra të Lotajve, që morën pjesë në këtë gjame. Me datën 16 prill 2024 u nda nga jeta Fran Mirashi, duke lënë pas një familje të mrekullueshme, të cilët do jenë krenar për këtë babe, zoti i pati dhënë bukurinë, zgjuarsinë, besën e burrërinë. Dihet se jeta e vdekja janë vetëm një frymë larg njëra tjetrës, por veprat e burrave të mirë nuk vdesin kurrë. Në përcjelljen e këtij burri për në banesën e fundit morën pjesë me qindra e qindra vetë, ngushëlluan familjen e Franit, shumë personalitete. Nga Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, Kryetari saj z. Ndue Sanaj si dhe nga Shoqata Mbare-kombëtare e “Pajtimit të Gjaqeve”- Dede Shullani e të tjerë.

Ne ju shprehim ngushëllimet tona, familjes e gjithë të afërmeve!

Ngushëllime i shprehim të gjithë fshatit Lotaj për ndarjen nga jeta të një burri të mrekullueshëm, që sot po e përcjellim për në banesën fundit!

Ngushëllime!

Pushofsh në paqe e dheu mbi varr të qoftë i lehtë, O NIP I JONI!

Lamtumire Fran Mirash Vukasani!

Përgatiti:

NDUE NIKOLL ZIÇI, maj 2024

dhe ekonominë e banorëve. Megjithatë rruga vazhdon të jetë jashtë çdo parametri sigurie dhe rrugëtimi.

Ekspertët pohojnë me shqetësim se, në pjesën më të madhe të zonave turistike në Veri të Shqipërisë mungon sinjalistika turistike si dhe shoqëruesit e çertifikuar për shtigjet malore.

Në rajonin e Alpeve, vitin e kaluar u

guida lokale dhe kjo na kushton jetë dhe shëndet, po ka edhe një kosto ekonomike, se nisim helikopterë, nisim makineri. Pra, në një farë mënyre vëmë në rrezik edhe jetën e njerëzve”, ka deklaruar zonja Kumbaro.

Zhvillimi i mëtejshëm i turizmit në Veri të Shqipërisë përballet me shumë sfida, mes të cilave, menaxhimi mbeturinave,

furnizimi me energji elektrike të pandërprerë, përmirësimi i infrastrukturës rrugore, por edhe përmirësimi i sistemit të sigurisë, sfida këto që është e vështirë të përballohen vetëm me fondet e bashkive të vogla.

Ndaj, sipas ekspertës së sektorit të trashëgimisë kulturore, Majlinda Laçaj, kërkohet një plan strategjik që t'i paraprijë ecurisë së mëtejshme të sektorit turistik.

“Së pari, institucionet përkatëse si Ministria e Turizmit dhe Mjedisit apo edhe institucione të tjera vendore duhet të kenë një plan menaxhimi strategjik përsa i përket menaxhimit të situatave të këtij niveli”, thotë ajo.

Strategjia e turizmit 2019-2023 ka muaj që ka përfunduar efektet e saj. Ndërkohë, megjithëse është muaji maj, Shqipëria ende nuk ka gati strategjinë e re të turizmit për vitin 2024-2030.

Sipas Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit gjatë muajve të parë të këtij viti numri i vizitorëve ishte 60 përqind më i lartë se ai i një vit më parë, tregues ku që dëshmon për ecurinë e mëtejshme të sektorit turistik. Në zonën veriore të Shqipërisë destinacionet turistike më të frekuentuara janë Valbona, Thethi, Vermoshi, Lëpusha, Boga dhe Razma.

Vështrim nga VOA, May 11 2024



*** Poezi nga Xhuliana Guri *** Poezi nga Xhuliana Guri ***

**MENDOJMË SE E DUAM**

E duam, sa fort që e duam me fjalë,
vendin ku lindëm, ku sytë shquan jetë.
E këtë dashuri vitet e mbulojnë ngadalë,
një hendek i madh ngrihet ashtu lehtë-lehtë.
E duam nga larg si toka qiellin,
e kujtojmë me këngë e tonat ligjërime.
Për mburrje e shohim si planetët diellin,
zhytur në ditarin e jetës tonë, plot kujtime.
E duam shpesh sa për sy e faqe,
botës t'i mbushim mendjen se jemi patriot.
Me mallin mundohemi të bëjmë paqe,
ia arrijmë në dukje, por zemra s'e bën dot.

E duam Shqipërinë si shqiponja folenë,
ehh, po eshtrat në mërgim një nga një lamë.
Të mirave të botës sy e mendje na gënjejnë,
Thamë: "Shqipëria nuk bëhet" e nga ajo u ndamë.

GJEJ KOHË TË DUASH

Koleksion gabimesh në rrugëtimin e jetës,
që shoqërojnë pa ndarë secilin njeri.
Sado të mos duam t'ia pranojmë vetes,
jemi qenie të gabueshme, si unë, si ti.
Gabimet e bëra, mbesin patjetër gabime,
vërtetë që ca vijnë si valë të lehta, e ca si stuhi.
Por mbase duhet hequr dorë nga ca gjykime,
zjarri i inatit, të mos bëjë çdo gjë, shkrumb e hi.
E në vend që të grisim atë faqe pa hezituar,
të gjejmë mënyrën si ta korrigjojmë.
Ç'e do njeriu një shpirt nga inati helmuar,
në vend të një jete, ku bashkë të mund të gëzojmë?
Ndër vite, dashurinë prangosëm e skllavëruam,
nga një e falur, që vështirë e lëshojmë.
Kurrë s'do kemi kohë njeri-tjetrit të duam,
për sa kohë që vetëm gëjojmë.

PAS SIKUR TË KTHEHEJ

Skenë e njohur, ky përfaqim i sinqertë,
të njohura këto ledhatime, mbi kokë fëmije.
Por sa e huaj sot gëzimi i një dashurie të vërtetë,
përballë këtij ambienti në shpirt burim trazie.
Sa i huaj vrapimi në lëndinat me lule,
këto këngë e valle që luhen përpara meje.
Sa kujtime o jetë në shpirt m'i ngule,

momente që si gjak lëvizin ndër deje.
Sa të largëta këto lojëra fëmijësh nëpër lagje,
dhe gjyshër me mbesa e nipër për dore kapur.
Në bllokun e jetës ka kaluar shumë nga ajo faqe,
kanë humbur në të shkuarën, me plagë hapur.
Mbeten të gjitha në atë kohë të largët,
atëherë kur unë gëzoja e lodroja sikur ti.
Ndaj shijoje këtë stinë të pakët,
si ato përrallat e bukura para gjumi.
Se mëngjesi i ri nga duart çdo gjë të rrëmben,
dhe jeta sfidante të lë peshqesh veç ca thërri.
Dhe në vrapimin e kësaj kohe që asnjë s'kursen,
të mbetet të helmohesh në të ëmblat kujtime.

AROMË JETE

Kandilet e varura në muret e zemrës,
u ndezën me radhë një e nga një.
Sinjale pa ndërprerje i jepnin mendjes,
asaj, që me llogari ishe e zënë, gjithnjë.
Bregat u shuan sikurse errësira,
një buzëqeshje drite shpresën ringjalli.
Vuajta për vite në të tharar shkretëtira,
mbytur ca nga vetmia, ca dhe nga malli.
Sa bluajti mulliri i torturës deri më sot,
nga brenda rrënuar, jashtë fasadë e gjallë.
Pas turmës veten s'e ndalua dot,
por iku tani, kësaj sfide i bëmë ballë.
Ja kumbonat e jetës, nga larg tek dëgjojen,
e gëzimi që festën shpallur sot ka.
Me mantelin e triumfit vlerat njerëzore mbulojen,
bashkë me dashurinë, që vetëm kurrë s'na la.

Viktimat më të mëdha të inflacionit dhe rritjes së çmimeve janë pensionistet

Pensionistet vijojnë të jenë shtresa më vulnerabil, nder vite me të njëjtat të ardhura. Mbase për vitin 2024 kishte prishmëri, kjo si rrjedhojë e premtimeve të pushtetarëve. Përsëri mbi 700 mijë pensionist mbeten të zhgënjyer. Tani zhgënjimi nuk paraqet problem se, ne u mësua. Të habitur jemi po doli ndonjë gjë e sakte. Kemi arrite aty sa me thënë lum si ne ç'a dëgjojmë, mjerët ne ç'a shohim! Kaluan mbi 10 vite duke pritur dhe deri kur? Një pjesë ikën në botën tjetër të mashtruar. Po sa do ikin, kësaj nuk i dihet. Po një gjë është e sigurt, se edhe këta do ikin të zhgënjyer. Detyrë e çdo brezi është të mundësojnë, që të moshuarve tu krijohen kushte për vitet e mbetura, të mos i kalojnë në skamje të tejskajshme. Ne mbetemi, duke falënderuar emigrantet, të cilët me remitancat na mundësojnë të jetuarit. Pra, e thënë troç na mbajnë gjallë.

Historikisht të majtët janë social, mendojnë për shtresat në nevojë e deri te shtresat e mesme. Tek ne ndodh e kundërta. Qeveria aktuale mendon për pushtetarët e oligarkët pranë saj. Fenomeni i rritjes së pagave të deputetëve e qeveritarëve në maj të vitit 2023 ishte një tregues shumë domethënës. Dyfishimi i rrogave të këtyre kategorive, nuk u prit mirë nga mbi 80 për qind e popullit. Sot një deputet ose "ballarë i kombit" merr një page prej 313

540 lek në muaj. Ndërsa një qeveritar merr 318 760 lek në muaj. Këtë ligj e votuan 95 deputet. Këtu, për veç deputeteve të shumicës votuan edhe deputet të opozitës. Rast i radhë kur bëhen të gjithë bashkë. Po, kur vjen puna tek xhepat e tyre, nuk ka kundërshtime.

Opozita duhej të votonte kundra, sa për të larë gojën. Një deputet apo qeveritar merr në muaj rrogë sa marrin pension rreth 20 veta. Gjithnjë duke e llogaritur pensionin mesatar prej 8,000 deri në 18,000 lek. Ne e dimë, se përveç pagave, deputetet e qeveritarët marrin edhe kompensime, siç janë: Dietat, karburanti, hotellet e të tjera. Madje gojë e liga thonë se për kurimin e tyre në spitale private apo jashtë shtetit u jepen edhe deri në 10 000 euro në vit. E përsëri një pjesë e tyre nuk janë të kënaqur, pa i ngjyer gishtat në korrupsion e deri me grupet kriminale. Pensionistet vazhdojnë jetën e tyre, duke blerë ilaçet, paguar ujin, energjinë elektrike e të tjera. Po mbeti për të blerë bukën thatë se ushqimet merren me listë.

Ne mburremi me arritjet në ekonomi, rriten të ardhurat, ulet borxhi publik, vijnë miliona turist e të tjera. Pensionistet përsëri me pensionet me të ulëta në Ballkanin Perëndimor, duke lënë pas vetëm Kosovën. Pensioni minimal në Mal të zi është 270 euro. Ndërsa ne e kemi 119

euro. Çmimet rriten pothuajse në progres gjeometrik, ndërsa pensionet sa vijnë e përkeqësohen. Indeksimi i pensioneve, kur rriten çmimet është detyrim ligjor. Kjo nuk quhet rritje e pensioneve, fonemën ky që përdoret si retorik nga pushteti. Madje edhe ky indeksim nuk bëhet i plotë edhe kur ka rritje të inflacionit. Ulja e kontribuuesve ka rënë, proporcioni është 1.1 kontribuues me 1 pensionist. Po çfarë faji kanë pensionistet?

Shpopullimin e vendit nuk e sollën pensionistet, por keqqeverisja e detyroi forcën vitale për punë të largohet në emigrim. Le të ndalemi te minimum jetik. Sipas bankës Botërore minimum jetik është 6.7 dollar në ditë. Kjo do të thotë se për një muaj, duhen 210 dollar. Kur ne e kemi pensionin minimal vetëm 119 dollar. Pra, ne jetojmë me minus 81 dollar të minimumit jetik. Për të dal nga kjo situatë, prioritet duhet dhënë dy shtyllave kryesore, siç janë industria e bujqësia. Sektor këta, që në krahasim me vitin 2022, kanë pësuar rënie, dhe rrezikon, rënie të punësuarve me 54 për qind në sektorin privat. Kjo do ndikonte negativisht edhe në rënie e kontribuuesve në sigurimet shoqërore. Nevojitet ndërhyrja shtetit nëpërmjet subvencioneve. Pozitivisht mendoj se do ndikonte edhe ulja e tarifave për të vetpunësuarit, në shumicën e rasteve të vetpunësuarit, nuk kanë mundësi të sigurohen, nga tarifave e larta në qytet e në fshat.

Mendojmë se variante ka, por nuk ka vullnet. Mbase edhe duke ndërhyrë në Kushtetutën e Shqipërisë, e cila tani është

bërë si thesi Çudit. Ndërhyhet kur ju intereson pushtetarëve dhe harrojnë shtresat në nevojë. Sikur parat e buxhetit të përdoshin e administroheshin siç e përcakton Kushtetuta dhe Ligjet, me siguri do gjendeshin fonde për rritjen e pensioneve.

Le t'u referohemi disa të dhënave të vitit 2023. Sipas KLSH demokritik e shkaktuar është 72.3 miliard lek, baras me 450 milion euro, janë detyrimet për arbitrazhet, sipas revistës "Monitor". Nuk po hyjmë te parat e vjedhura, nga tenderët, me rrugët, për zyrat e udhëtimit brenda e jashtë vendit e të tjera. Vetëm gjysma e këtyre shumave të përdorej për rritjen e pensioneve, mesatarisht çdo pensionist do të marr një shtesë të konsiderueshme.

Ne u ndalem vetëm në dy tregues, se sa e sa vend ka për të gjetur burime të ardhurash për shtresat në nevojë. Kjo shtresë të jetë e barabarte me këto shtresa që jetojnë në vendet për rreth nesh. Pra, në Ballkanin Perëndimor.

Mendjen e kemi se kur të vijë viti i ri t' i gëzohemi 5 000 lekëve, për të blerë 1/3 e gjelit se, me çmimet aktuale, për gjysmën tjetër nuk bëhet fjalë.

Shpresojmë se ditë ma të mira do vijnë, për ne, Qeveria do gjejë rrugë e mekanizma, për rritjen reale të pensioneve.

Na mbetet të shpresojmë, pasi po hymë në vitin elektoral dhe gjasat janë që stimulum i vetëm do jetë ai i zarfeve. Megjithatë shpresa vdes e fundit!

Përgatiti NDUE ZIÇI

REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj
Luigj Shyti, Prele Milani, Lazer Kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,
Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli,
Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani,
Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

Mundësuan Botimin
mësuesit pensionistë:

**ZEF TOKA
MARTIN ARRA**

